

Kur të vret e mira...

(Dramë në gjashtë tablo)

Vetat :

Tana - nëna

Gramozi - djali i madh, kryeagronom

Shkëlqimi - djali i dytë, inxhinier, drejtor uzine

Visari - djali i vogël, punëtor

Donika - e bija, mercologe

Lira - e fejuara e Shkëlqimit, mësuese

Fuati - i ati i Lirës, shkrimtar

Besniku - inxhinier, shok i ngushtë i Shkëlqimit

Bujari - shok i Shkëlqimit, punëtor

Besimi - shoferi i Shkëlqimit

Perlati - komshi, punëtor i vjetër i uzinës

Lela - e bija e Perlatit

Regjisore : Margerita Koka

Premiera më, 27.04.1988 ne Teatrin "Migjeni" Shkodër

Prologu

Në të djathtë një kënd i oborrit të ndërmarrjes dhe një cep i lulishtës. Besniku pa nxituar ecën ngadalë, nxjerr nga xhepi një paketë cigare dhe e ndez një. Përballë tij me një hekurishtë në dorë vjen Besimi, që ndal hapin.

Besimi – Më jep një cigare, se m'u ç'a hunda! Kam gjithë paraditën që merrem me kamion e makinës.

Besniku – Urdhëro! (ia jep) Problem?

Besimi – Thashë ta bëj xixë, para se të fillojë punë drejtori i ri... Dëgjova se ikën drejtoresha...

Besniku – Ashtu dëgjova edhe unë... Ti mirë bën! Makina duhet të jetë në gadishmëri...

Besimi – Urime!

Besniku – Për çfarë?

Besimi – Mos u hiq sikur s'di! Mua më tha Viktori, se të kanë propozuar ty...

Besniku – Tjetër është të të propozojnë, e tjetër të jesh...

Besimi – Punë ditësh...

Besniku – Jo, Besim, nuk është gjë që behet...

Besimi – Pse, ku do të gjejnë më të mirë? Ta them me gjithë mend, e jo pse do të të kemi të parë...

Besniku – Të falenderoj, Beso, po nuk do të plotësohet dëshira e mirë që ke...

Besimi – Pse?

Besniku – E kam refuzuar propozimin...

Besimi – Qenke budalla i madh! Pse ta refuzosh?

Besniku – Se nuk jam i prerë për drejtor... (Besimi matet të thotë diçka. Besniku e ndërpret) Dhe se dua të merrem me pasionin tim... Dua të rikonstruktoj repartin e parë... Më mirë një inxhinier për të qenë, se një drejtor i keq!... (i bie supit) Megjithatë, ti mos u merakos, se kush do të ulet në sediljen e parë... Me siguri, ndonjë nga shokët tanë do të jetë...

Besimi – Më qafsh, më thuaj një emër!..

Besniku – Ik, tani e rregullo kamion,se të nuk ke kohë...

Dritat

Tabloja e parë

Dy vite më pas.Mbasdreke.Shtëpia e nënë Tanës.Në pamje të parë një sallon i madh,ku bien në sy dy divanë:njëri në të majtë,diku pranë shkallëve që ngjiten në katin e dytë dhe tjetri në të djathtë,ku ka një verandë.Nëbalë dyer që të çojnë në dhoma.Në të majtë është porta e hyrjes.Nga njera prej dyerve në ballë del Visari.Ai shkon tek frigoriferi.E hap dhe e mbyll.

Visari – (Tanës)Nuk paska ujë të ftohtë?

Tana – Ka.Ja ku është..Po ti pse u zgjove kaq e shpejt,Visar?

Visari – Kokën ma ke bërë vertetë,po ende se ke mësuar që unëkam gjumë lepuri,mama!...Kush ishte ai qëbërtiste aq fort?

Tana – Petroja.

Visari – Ah,të keqen e zërit!

Tana – Shko shtrihu prap,se do të punosh gjithë natën!

Nga kati i dytë zbret Donika me njëgazetë në dorë.

Donika – Mama,mama,paskan shkruar për Shkëlqimin!

Tana – Vërtetë?

Donika – Po.Ja ç’shkruan: “Në bisedën që patëm me drejtorin e uzinës Shkëlqim Dani,pasi na foli për realizimin e detyrave në të gjithë treguesit, në mes të tjerave na tha,se së shpejti me forcat e tyre do të ngrinin një linjë të re për prodhimin e një malli shumë të kerkuar nga eksporti.”

Visari – Të lumtë,vëllaçko!(Tanës)Ke djalë e jo përralla!

Tana – Të mirë ju kam të gjithëve...

Visari – Po,veç se për asnjërin prej nesh,brenda një kohe të shkurtër,nuk ka folur aq shumë në radio,televizor e gazeta!...

Donika – Punët i kanë shkuar mbarë këto dy vite...Ti nuk gëzohesh?

Vissari – Oj,të gëzuar!Bile, nuk e di në ç'ngjyrë duhet ta vë tani e tutje kollaren!...

Tana – Po flet mbrapsht!Dhe se ç'e ke një mllef!

Visari –E do troç?Nuk më pëlqejnë pompat...Intervista në radio, televizion, në gazetë...Sikur e ndjek prapa dikush...

Donika – Të japësh përvojën për një punë të mirë e quake pompë ti?

Visari – Moj,më dëgjoni mua se ç'them!Edhe pse jam bira e fundit e kavallit në këtë shtëpi,nuhatjen e kam të fortë.Hë, mama,pash kokën tënde,thuaji kësaj:a nuk e gjej vetëm me nuhatje që nga rruga se ç'po gatuan?Fol,të keqen,mos më lë të gënjej!...

Tana – Visar,ty nuk të kuptoj,kur tallesh e kur flet seriozisht...

Donika – Ç'i vë vesh këtij,moj nënë!Ia këput kot!Me sa duket i mban inatin e mbrëmshëm, pse Shkëlqimi ia bëri naaa!Mirë ta bëri!Na ngrive gjakun... Ç'më shikon ashtu?Mirë të ta.Pse vihet në mesnatë?Pa le,pa,edhe i pirë!

Visari –Një herë vetëm ndodhi dhe ju thashë ku isha!

Tana – Po ai shqetesohet,more bir,se të ka vëlla...

Visari – Për mua?Më shkrive!...Ai më tepër ka hallin e vet, se mos i prish perspektivën...

Tana – Jo,Visar,nuk është ashtu...Dhe nuk e kuptoj, pse flet ashtu për tët vëlla!

Visari – Se ka filluar t'ia bëjë pak si shumë vetes me sy,prandaj...Nuk e keni vënë re, se edhe në shtëpi ka nisur tësillet si drejtor?

Donika –Flet kot!

Visari – Mbrojeni,mbrojeni!

Tana – Visar,e di qëpo më mërzit?Në ke gjë për t'i thënë,thuaja, por mos e gjuaj me thumba!

Visari – Konkrete asgjë nuk kam,po,hë,pra, çfaj kam unë që nuhas?

Tana – Edhe ky Gramozi,kaq kohë pa ardhur!

Visari – Ç'ke me Gramozin?Lëre të qetë atje ku është në malësi...

Tana – Jo,se keni të grindeni tash e parë, kot së koti,prandaj...Te keqen nëna,Visar,ti je më i vogël,hapi rrugë...Ka edhe telashe më shumë se ti...Visari – Mirë,mirë,mos u mërzit!E di,se e teproj ndonjëherë...(e puth)Po shkoj të shtrihem...Donika,po më zuri gjumi,më zgjo në orën shtatë!

Donika – Ç’është ky orar interesant?Pëshembull,pse jo në nëntë,që të hash bukë e t’ia mbathësh për punë?

Visari – Mojl!

Visari e ndjek.Donika ngjit shkallët me vrap duke qeshur.Visari futet në dhomën e tij.Tana i ndjek me sy duke tundur kokën,pastaj rri një çast menduar dhe matet të hyjë në dhomën tjetër.Nga porta tjetër hyn Besniku.

Tana – (e përqafton) Po si je,o Besnik, se ke humbur fare?!

Besniku – Mirë,nënë Tana,shumë mirë...Me ty e kam prishur,por kam qenë shumë i zënë...Shkëlqimi këtu është?

Tana – Lajmëroi në telefon,se vonohet.Në punë do të jetë.Nuk e paske takuar sot?

Besniku – Në mëngjes.

Tana – Mbeti në uzinë,o Niku...Më rehat ishte më parë si inxhinier...

Besniku – Mos i fut vetes merak,o nënë,se nuk është i vogël...

Tana – U rritët,ju pastë nëna,u rritët!..Rriteni ju,plakemi ne...Kështu e ka kjo jetë...

Ja(bën me shenjë),kaq ishit,kur vinit me Bujarin të thërrisnit Shkëlqimin...

Besniku – Dhe bëheshit merak ndonjëherë, kur harroheshim në lojë...

Tana – Do të bëhesh prind e do ta kuptosh!

Besnik – Ç’është e vërteta ti shqetësoheshe pak më shumë, se ç’duhej...

Tana – I kam rritur me gjak të zemrës,o Niku,se im shoq,i ndjeri,m’i la prush...Visarin ma lanë gjë...Tërë barrën e ndava me Gramozin...Ai më ka hequr shumë...

Besniku – Ke tëdrejtë!E di, se më ka marrëmalli për Gramozin?U bë kaç kohë ,që s’e kam parë!

Tana – Mbeti atje,në malësi.Vjen a s’vjen njëherë në muaj...Sidomos tani qëka marrë gruan e fëmijët...Kolopuçët e gjyshes!Më ka marrë malli!...(kujtohet për diçka)Po punët atje në uzinë,o Niku,mirëju shkojnë?

Besniku –Mirë,shumë mirë!

Tana – Po Shkëlqimi,ia shkrep ndonjë çikë si drejtor,apo si?

Donika ka dëgjuar zërin dhe zbret ngadalë

Besniku – Si jo!Tani edhe telashe ka, po nuk është lehtë të drejtosh një uzinë si e jona, që shumicën e mallrave i prodhon për eksport...E lexove gazetën sot?(*Tana tund kokën në shenjë pohimi*)

Donika zbret me të shpejtë.Bën sikur nuk e vë re Besnikun.

Donika – Mama,mos ke parë gjë librin,që kisha në dorë?

Tana – Donika!

Donika – Ou,më fal,Besnik!Nuk të vura re...

Besniku – S’ke faj,jam edhe i vogël!...

Donika – Jo,kështu je sa një zdap,po nuk e kisha mendjen...

Tana – Moj, je në vete?

Donika – Mos i fut kot zor vetes,moj nënë,se mban ky,mban...

Tana – Shko piqja kafënë,se u mora me muhabet e më doli nga mendja...

Donika – Ku i pëlqen kafja e ime këtij?Është buzëhollë i madh...Është mësuar hidrocentraleve me kafe banaku!...Ti, mama,ç’është e vërtet, e qan...

Tana - Lëri,moj,llafet,se je goxha vajzë e s’ të ka hije...Thirri,moj, mendjes, se i mbushe plot 24...

Donika – Tani e shkele,mama!Nuk tregohet mosha e vajzës në sy të të huajve!...Mua s’më bëhet gjë,po ty të mbes në derë!...

Tana – Je një budallaçkë ti,që nuk e ke shoqen!Mirë që Niku të njeh qysh të vogël,se kushedi ç’do të mendonte një tjetër...(del)

Donika – Ty të solli njeri këtu,apo erdhe vetë?

Besniku – Vetë erdha...Mos bëra gabim?

Donika – Jo,thashë,se, kur tjetri s’vjen për një kohë të gjatë,s’është çudi të harrojë edhe shtëpinë...Më parë s’kishte ditë që të mos vije,apo ka luajtur gjë?

Besniku – Asgjë nuk ka luajtur...

Donika – Ma mbushe mendjen!Nuk ka si të jetë tjetër, kur ke shtatë ditë pa ardhur...

Besniku – Kam patur shumë punë...

Donika – Tëpaktën për nënën, se për ne të tjerët pak rëndësi ka...

Besniku – Di gjë për Shkëlqimin?

Donika – Jo. Po ty mirë që të paska dalë një punë me të, që të vije... Le që ti vazhdimisht ke ardhur... Mbase, ndonjëherë përmirësjellje edhe për mamanë... *(Besniku hesht)* Ti je njeriu më i çuditshëm që kam parë në jetën time!...

Besniku – Është heret të flasësh për jetën tënde! Ti sapo e ke nisur... Kushedi sa të tjerë si unë do të ndeshësh!

Donika – Të kesh punë me njerëz si ti, duhet të shpërblehesh për vështirësi pune... *(Besniku ngrihet)* Si t' i them mamasë, kur të sjellë kafënë? *(ai ulet)*

Hyn Bujari

Bujari – Tungjatjeta juaj! Mirë je, Donika? Mamaja, vëllezrit, mirë keni qenë të gjithë? E po gëzohem. Desha drejtorin.. Nuk qenka këtu? Ja, po e pres.. *(ulet)* Është interesant me disa njerëz, ti ngulin sytë, sikur do të të hanë, emeazallah se ta thonë një fjalë... Ndoshta janë edhe memecë, xhanëm!... S'kanë faj!...

Besniku – Edhe sikur të duan të flasin, ku të lë rradhë ti, që grin si motor!

Donika – S'është për t'u habitur, se motorist punon...

Bujari – Shumë të faleminderit, shoqja mercologe, se më the diçka që nuk e dija... *(nuhat)* Për kokë të djalit, matanë po piqet kafe!... Nanë Tana, unë e dua me shumë! Ashtu t'u bëfsha! Ç' mi keni ngulur llambushkat? Nuk ju ka rënë rasti të shihni ndonjëherë motorist me sy? Ja, kënaquni: Bujar Zeka, një e tetëdhjetë i gjatë, tetëdhjetë e dy kilogramë, me arsim të detyruar tetëvjeçar, dhjetë vjet i martuar, baba shembullor i tri vajzave shembullore, që njëra, me siguri, tash ia ka dhënë kujës në çerdhe, ngaqë e ëma është turn i dytë, kurse i ati vjen e grin këtu sallatë...

Besniku – Ti, Bujar, je karagjoz! E shkreta Lume ç'heq me ty!

Bujari – Stop! Erdhën kafetë! *(ngrihet dhe i del Tanës para)*

Tana – Të keqen, Bujar, që ia shton shendin kësaj shtëpie, kur vjen! Aaa, prit, më përpara Nikut!

Bujari – E prishe, nënë Tana, po bën dallime profesionale! Po mu tek, nuk ta marr fare kafënë!...

Tana – E di,e di,po Niku ka adhur para teje...

Bujari – E po,mirë,me që thua ti!...E di si është puna?Ky i mençuri këtu pak më parë më quajti karagjoz.Jam karagjoz unë?

Tana – Ia ka këputë kot!Nuk është e vërtetë!..

Bujari – Eshtë,se ky,që na e mban veten për të zot e me kulturë,s’ka hiç kulturë,sepse nuk di turqisht...Në turqisht “karagjoz” do të thotë “syzi”...E shikon pra që unë jam karagjoz?(*qeshin*)

Donika – Ky për ditë e më i lezetshëm bëhet...Ka filluar të marrë edhe kulturë të gjërë!...

Bujari – E po,si mund të ndodhë ndryshe,kur ke shok këtë(*për Nikun*) dhe atë(*për Shkëlqimin*)Pastaj e di ti, sa i mirë kam qenë në tetëvjeçare? Pyeteni drejtorin,që e kisha shok banke,kur të vijë...Zheni kam qenë,aq sa, po të mos m’i tregonte Çimi detyrat,perkokën e djalit,vetëm katra do të merrja...Po aq mend kisha atëherë...S’di ja gjë tjetër veç hekurash!...

Tana – Ama,duart ike të arta!

Bujari- Jam penduar si derr për shkollën...Po tani është vonë...(befas)Kurse ky këtu,ishte dy vjet poshtë nesh...Ka qenë fëmijëi lezetshëm,buçko,po ne e thirrshim “gocë” se skuqej për hiç gjë...Ja, shiheni,shiheni,edhe tani u skuq,për kokë të çunit!...

Donika – Për kokë të tri vajzave,thuaj..

Bujari –Ku merr vesh ti!Ktheje kokën matanë!(*Tanës*)Këtë herë ma ka treguar njeri një formulë e do ta kem djalë,se s’bën!...(qeshin) Megjithate drejtori s’po vjen! S’është e lehtë,more vëlla,ka telashe dynjaja!Ika tani,se më mbeti vajza në çerdhe!Po e lë tek komshiu e po vij t’u çaj veshët prap! Po s’erdha, i thoni Çimit,se më kanë munguar dhjetë pllaka të bardha. Hajt, shëndet!

Besniku – Prit,Bujar,se po vi edhe unë!(*dalin*)

Ne dalje gati sa nuk përplasen me Lelën.

Lela – Si jeni,inxhinier?

Besniku – Mirë,Lela..Po ti?

Lela –Hiç, për ca kripë...Na ishte mbaruar...

Besniku – Natën e mirë!(*largohet*)

Lela – Nënë Tana,të qëllon pak kripë?

Tana – Posi,moj xhan!(*shkon ta marrë*)

Lela – Hë?

Donika – Hiç.

Lela – Si hiç?

Donika – Lermë,Lela,të keqen!(*vjen Tana*)

Lela – Të faleminderit,se kam gjellën në zjarr..*(Donikës)*Ti nuk po më përcjell?*(Dalin e pastaj ndalin në korridor)* Hë,e pashë nga dritarja,kur erdhi...

Donika – Asgjë nuk kuptoj...Jam trullosur fare...Nuk është më ai i pari...Ka ndryshuar...Ndoshta i bie në qafë kot...Mbase ai sillet me mua thjeshtë si me motrën e një shoku...Dhe vetëm kaq..

Lela – Qenke budallaqe!Atëherë,pse thua se ka ndryshuar?

Donika – Kështu më duket mua!...

Lela – Nuk ka ndryshim pa shkak...

Donika – Vras mendjen e nuk e gjej.Po unë e dua,Lela!Dhe mëvjen inat, se rashë brenda pa e kuptuar..Si ndodhka kështu?Ndoshta ti rri shpesh me një njeri,qesh lirshëm me të,e ngacmon pa të keq,e quan vëlla,kur befaz kupton se diçka ka ndryshuar...Tani i numëroj ditët,kur nuk e shoh,nuk më pritet sa t'i dëgjoj zërin,s'ngopem të rri me të për orë të tëra,kurse ai më shmanget...

Lela – Më mallëngjeve!Fillo tani të këndosh këngë sentimentale,të flasësh me yjet e hënën,të vizatosh zemra që pikojnë gjak...Si një adoleshente...

Donika – Mos u tall!Mund ta frenoj veten!..Gjërat duhen parë me realizëm... Tek e fundit,ç'faj ka ai,se unë lajthita si një çupërlinë?...

Lela – Prap po flet e ndezur!...Besniku është tip i ndrojtur...Po ju,që të dy jeni një çift budallenjsh!Unë them t'i hapesh e para...

Nga dhoma del Visari.Ata nuk e shohin.

Donika – Mos u çmende?

Lela- Aspak!Jam krejt ne rregull,siç e sheh!...Dhe ketu s'ka asgjë të tmerrëshme për të vënë kujën...Apo s' duam të prishim traditën! Posi!Mirë atëherë, rri e plas përbrënda,si gjinkalla në zheg...Ika unë se po vjen Shkëlqimi...

Lela del me të shpejtë.Donika futet brenda.Ndesh në vështrimin e Visarit.

Visari – U pa puna!Sonte gjithë natën do të kotem në punë...

Donika – Nuk fjete?

Visari – Pse flihet këtu?Si zyrë dispetçeri...Kush ishte?

Donika – Niku,Bujari dhe Lela...

Visari – Ç’thoste Niku,mirë ishte?

Donika – Ashtu m’u duk se tha...

Visari – Më bëhet qejfi...Kishte ditë pa ardhur!...Kujtova mos kishte qenë i sëmurë...

Donika – Pse s’ke shkuar ta takosh?Shtëpinë ia di...

Visari – Hë,pra,krejt kot!Alamet djali!Më kanë thënë,se vajzat e uzinës ngordhin për të...

Donika – Vërtetë?

Visari – Pse, ty s’të duket djalë i mirë?

Donika – Ç’punë kam unë,i mirë a i keq!Ai ka shok Shkëlqimin,jo mua...

Visari – Më fal,se harrova...

Hyn Shkëlqimi.

Donika – Hë,Çimi, a u lodhe?

Shkëlqimi – (*i vë dorën në sup*) Po edhe u lodha ca,moj motër... Ti,Visar, pushove ndopak?

Visari – Hiç,eja njëri,eja tjetri...(Hyn Tana)

Tana – Po ç’u bëre,mor bir, e mbyte veten!

Shkëlqimi – (*e përqafton*)Të rinj jemi,edhe do të lodhemi..

Tana – Po,por çdo gjëme karar...

Shkëlqimi – (*si me shaka*)E shkele,nënë!Kollaj tëpërmendni ju tëvjetrit stafetën!...Epo ajo do mund për ta mbajtur e çuar më tej...Do djersë,netë pa gjumë,apo i harroni këto,kur bëhet fjalë për fëmijët tuaj...Po e di ç’ke ti,a më pjek një kafe,siç e di ti?(*Tana del*)Ka marrë gjë Lira në telefon ?

Donika – Jo.(*kujtohet për diçka*)Pashë një fustan shumë të bukur sot për Lirën...

Shkëlqimi – Boll ka...Siç e ke nisur,do të ma marrësjh në qafë!...Sa më thjesht,aq më mirë!...Shiko,shiko,i vari vetullat kjo!

Donika – Kot që të them,për ty vetëm uzina ka vlerë!...

Shkëlqimi – Ti bën mirë të shohësh problemet e tua, se Lira e ka zgjidhur atë më kryesorin...Ej,thirri mendjes,se po të ikin koha!...Çdo ditë që shkon,t'i zbret karatët!Jo p-ër gjë,po edhe Visari pret rradhën,apo e kam gabim?

Visar- Mirë e ke,se edhe nëna mezi pret nusen e vogël t'i vijë nështëpi!Jo për gjë, po që jam më i sigurti,prandaj!

Shkëlqimi – Pse?

Visari – Gramozi është disllokuar në malësi, ti,nuk i dihet, ku të çon detyra, kurse unë jam i patundshëm,punëtor hesapi...(Tana sjell kafën)

Shkëlqimi – *(si me shaka)*Paske vendosur të më japësh duart?(Tanës) Dëgjoje,dëgjojë,se ç'thotë!

Visari – Po atëherë,pse e more shtëpinë e re?A nuk ke thënë vetë,se këtu jemi ngushtë?

Shkëlqimi – Po ashtu kam thënë dhe ashtu është,po unë bëra shaka...E di se ndonjëherë të kam zili,Visar?

Visari – Mua?S'ma do mendja...

Shkëlqimi – E them sinqerisht,se ti vërtetë lodhesh,po mbasi mbaron tetë orëshin,je valencë e lirë...Ku rafsha,mos u vrafsha!...

Visari – Nuk është krejt ashtu,kemi edhe ne tonat...

Shkëlqimi – Më duket se s'të paska kaluar ende inati i mbrëmshëm...Po unë për ty e kam...

Visari – E di,e di, se edhe ju s'keni mirë,po të shkas unë...

Shkëlqimi – Nuk shket jo, se kjo shtëpi nuk është turpëruar ndonjëherë...

Hyjnë Fuati meLirën.Tana u del përpara me të shpejtë.

Tana – Mirë se erdhët!Si jeni,krushk?Gruaja mirë,djali?Po ti,moj nusja e nënës?(e përqaфон)

Fuati – Si keni qenë,krushkë?Të gjithë mirë janë?Andej nga Gramozi mirë?

Tana – Njl muaj pa ardhur!

Fuati – Ti je një nënë e lumtur,krushkë!Fëmijët i rrite të ndershëm e të mirë dhe ata ta shpërblyen.Ja Gramozi kryeagronom i njohur,Shkëlqimi drejtor, Donika mercologe...Vetëm Visarin nuk e bëre me shkollë të lartë,po s'ka gjë(*si me shaka*) duhet njëri për të ruajtur

prejardhjen klasore,apo jo, Visar, se yt atë,i ndjeri,ka qenë një punëtor i ndershëm e i nderuar.Mua s'më takon,se jemi tanët,po do t'i them një shoku të bëjë një shkrim në gazetë...

Tana – Paç faqen e bardhë,o krushk,po kam frikë,se mos më rriten veshët, tash në pleqëri!...(qeshin)

Fuati – (Shkëlqimit)Si ia kalove sot?

Shkelqimi – Sapo erdha në shtëpi.

Fuati – Siç ia ke nisur,do të prishesh me nusen!

Shkëlqimi – Nuset e kuadrove duhet të sakrifikojnë...

Lira – (Tanës)Po e bëjmë fejesen si me korespondencë,mama,gjithmonë i zënë!..

Shkëlqimi – Ka gjëra që qëndojnë më lart se ata intimet...Ti e kupton këtë,Lira,duhet të më justifikosh...

Tana – U harruam në muhabet...Donika,kafetë!A po ke qejf ti bësh ti,Lira?

Lira – Bashkë me Donikën.(Dalin)

Fuati – Shoku Munir e ka Shkëlqimin pikë të dobët...Flet me simpati të madhe për të...

Tana – Pastë faqen e bardhë kush flet e mendon mirë!Po ky t'ia bëjë hyzmetin punës e të na nderojë...(Shkëlqimi vë buzën në gaz dhe e përqafton)Harrova të të them se të kërkuan Niku e Bujari..

Shkëlqimi – Ashtu?Ç'thanë?

Tana – Dëshën të të takonin..

Fuati – Me siguri për artikullin.Shokët gëzohen për sukseset e njeri tjetrit...A është Besniku inxhinier i zoti,Shkëlqim?

Shkëlqimi – Shumë...

Fuati – Kam dëgjuar, se edhe ai ka qenë piketuar si kandidat për atë karrige...

Shkëlqimi – Besniku?Për ç'karrige e ke fjalën?

Visari – Për karrigen e presidentit!..

Fuati – Nuk tallem...

Shkëlqimi – Mbase,unë nuk di gjë!...

Fuati – Kurse ky Bujari më duket shpirt njeriu...Me siguri,prandaj e ke ruajtur shoqërinë me të,se kështu,nga kultura s'të lidh gjë...

Shkëlqimi – Është shumë i lezetshëm dhe më do shumë.E di ç'punime ka bërë ne shtëpinë e re?Habitesh.Ç'i sheh syri, i bën dora!Po ç'e do, nuk pati shkollë...Ka mbetur mjeshtër hekurash,pak a shumë si im vëlla...

Visari – Jnaë ndarë rrisqet.Unë me hekura,Gramozi me arat,ti me drejtim, ju, (*Fuatit*) me librat..Meqë ra fjala,si u bë puna e atij romanit që keni dërguar prej kohësh për botim?

Fuati – Të shkruash,i dashur Visar,është njëra anë,të botosh është tjetra...Se ashtu siç kemi huqe ne shkrintarët, ashtu kanë edhe botuesit... Shkurt,nuk i mbushet mendja redaktorit...

Visari – Ashtu kot?

Fuati – Sa kokë ka,aq mendje...Megjithate jam në përfundim të një libri të ri...

Visari – Uroj të bjerë në dorë të mirë!..

Fuati – Jy vëllai yt,Shkëlqim,ka një humor me piper...(surbon kafenë)Për të mirë krushkë!

Tana – Ju bëftë mirë!

Fuati – Mua të më falni,se u bë vonë...Lira,do të rrish?

Lira – Jo,baba,po vi..

Tana – Po ju rrini edhe pak...

Fuati – Shpresa do të jetë mëzitur.E kemi lënë të shkojmë për një vizitë:Natën e mirë!(dalin)

Shkëlqimi – (*Visarit*)Të kam thënë me kohë, se je rrugaç dhe i pa edukatë!

Tana – Si i thua kështu tët vëllai?

Shkëlqimi – Kjo është pak.Nuk ia dëgjove thumbat?

Visari – Kush të dojë t'i marrë për thumba,kush të dojë për gozhdë dhe tjetër herë mos fol kështu me mua, se nuk jam kalama..

Shkëlqimi – Edhe më keq je,se nuk di të sillesh me njerëzit që të vinë në shtëpi..

Visari – Edhe kur të shesin dëngla?Tek e fundit,nuk thashë ndonjë të pavërtetë,se një copë dështaku është...

Shkëlqimi – Si guxon të flasësh kështu?

Visari – Po,po dështak,pa “ë” në fund!Tërë ditën bredh kafe n’kafe ,herë me shokun M e herë me shokun N,duke marrë nepër gojë dynjanë...Edhe këtu i dha sinjalet...Jo shoku Munir kështu,Jo Niku kandidat,jo Bujari pa kulturë..,

Shkëlqimi – (Tanës)E dëgjon të përkëdhelurin tënd?Dëgjoje,dëgjoje,se me këtë kokkë që ka,do t’ia pimë lëngun ndonjë ditë...

Visari – Ose anasjelltas...

Tana – Po ç’bëni,more kështu, se jeni vëllezër?!

Shkëlqimi – Ky është mosmirënjohës!

Visari – E di që ke bërë shumë për mua,se,edhe pse nuk isha nxënës shumë i mirë,ke ngulur këmbë të vazhdoja shkollën e mesme...Madje më ke ndihmuar edhe me vizatimin teknik...E shikon, që i di përmendësh të mirat e tua?Megjithatë nuk t’i fërkoj krahët,siç bën vjehri yt...

Hyn Gramozi.

Gramozi – Ç’bëni,more kështu,se çuditët mehallën?

Tana – (*i del para*) Gramoz, bir,sa mirë që erdhe!

Gramozi – (*qetë*)Ç’ka ngjarë?

Visari – Hiç,po provonim tonalitetet!

Tana – Leri shakatë ti!

Gramozi – Pse, moj nënë,kështu pritet miku?Hajde t’iu përqafoj njëherë, se më ka marrë malli!(*përqafohen*)Po s’keni faj ju!Të gjithë grumbull nën këtë çati dhe s’pyesni për jabanxhinjtë..(*Tanës*)Ke bërë ndonë gjë të mirë sonte?Po ç’pyes edhe unë!Ti edhe me sy mbyllur i bën gjellët më të mira se Vjollca ime,megjithese ajo gatuan me libër përpara...Donika,të keqen vëllai, më bëj gati dushin,se jam gjithë pluhur...

Shkëlqimi – Pse?

Gramozi – Na është prishur ajo rrangallja jonë...

Shkëlqimi – Nuk mund të gjesh një makinë tjetër?Po shoh një herë unë...

Gramozi – E ç’pyet,se mos lëvizim shumë ne...Më tepër me mushkë...Ose u hypim këmbëve..Është vend i thyer,po shumë i bukur...(Tanës)Po të marr ca ditë,se edhe fëmijët s’të heqin goje..Pa,ha,njëherë,si jeni këndeje? Ti, nënoke,mirë?

Tana – Ja,ç’ka,po mirë,mirë..

Gramozi – Po ti,Çimi?Mirë më dukesh:Lexova gazetën.Ju lumtë!(Visarit i shpupurit flokët)Po ti,kaqol,lodhesh ndonjë çikë?

Visari – Jo dhe aq...

Tana – Po ku je, o Gramoz, se humbe?

Gramozi – Eee,kështu e kemi ne.Edhe sonte s’do të kisha ardhur, po të mos më kishin thirur...

Shkëlqimi – Ku?

Gramozi – Ja,atje, lart!Kam për të marrë një dru,që ta mbaj mend...

Shkëlqimi – Sikur s’ tu bëka shumë vonë!

Gramozi – Ç’ të bëj?T’ia jap kujës?E di që kanë të drejtë!

Shkëlqimi – Si është puna?

Gramozi – Nuk jemi mirë me numrin e krerëve...Boll jemi afuar,po s’ia kemi gjetur tamam rrëfanën, siç duhet...

Shkëlqimi – Pse, mos do të japësh llogari për “kurbanët”e therur para se të shkoje ti?

Gramozi – S’matet me te shkuarën,vëllaçko!

Donika – Gati e ke, Gramoz !

Gramozi – Ja erdha!Shtrojeni tryezën, se më ka grirë uria...

dritat

Tablo e dytë

*Të nesërmen pasdreke.I njejt dekor.Shkëlqimi dhe Lira.Bie zilja e telefonit.
Lira,që është më afër,matet të shkojë për të ngritur dorezën.*

Shkëlqimi – Lëre,lëre!Për ndonjë punë do të jetë!

Lira – Ua, filloi shiu!E unë, budallaqja,dola pa çadër....

Shkëlqimi – (i afrohet)Aq më mirë,do të rrimë më shumë...

Lira – Jo,kam gjithë ato hartime për të korrigjuar.

Shkëlqimi – Leri për më vonë...Na ka marrë malli të rrimë njëherë bashkë!..

Lira – Ç’faj kam unë?Vetë më thua, se je vazhdimisht i zënë...

Shkëlqimi – Është e vërtetë,po sot gjithë pasdreken e kam vënë në dispozicionin tënd.Dua të bëj një autokritikë me vepra(*e përqafo*)..Dhe kam dëshirë veç të flas...

Lira – Dhe unë veç do të dëgjoj!...

Shkëlqimi – Nuk e merr me mend se ç’ndjenja më ziejnë përbrënda!E përfytyron dot?

Lira – Ku ta di unë,po me sa ma pret,them se duhet të jesh i lumtur...

Shkëlqimi – “I lumtur” është fjalë e madhe, i gëzuar po...

Lira – Po ç’i mundon gëzimit tënd,që të shndrrohet në lumturi?

Shkëlqimi – Si çdo njeri edhe unë kam ëndrrat e mia...Për derisa ato nuk janë bërë realitet të gjitha,do të thotë,se diçka më mungon për t’ i dhënë të drejtën vetes të quhem i lumtur...

Lira – Mua më duket,se jeta me ty është treguar dorëlëshuar...

Shkëlqimi – Nuk qahem!Po unë kam të drejtë të kërkoj prap prej saj,bile, po qe nevoja,t’ia rrëmbej me pahir,në ngurroftë ajo sado pak...

Lira – (*qesh*) Shiko,shiko,si t’u ndezën sytë...Ej,kujdes,se po më djeg!

Shkëlqimi – Mos ke frikë!E di masën dhe e di si duhet hedhur hapi!

Lira – Hapin duhet ta hedhësh si të gjithë...

Shkëlqimi – Gabove!Nuk mund të ecin njëloj një shalëgjatë me një shkurtabiq!...

Lira – Edhe shalëgjati nuk duhet të ngutet!...Kush ecën pa u ngutur,shkon larg dhe aty ku duhet....Kështu?(*i përkëdhel flokët*)Nejse,me duket,se hymë në të thella.Më thuaj diçka për atë linjën e re,po sa më thjeshtë,se nuk marr vesh nga teknika...

Shkëlqimi – Më ka lodhur shumë.Me dy fjalë,shpikja ime qëndron në faktin,që nga hiçi të bësh prokopi të madhe...E kupton,ç'leverdi ka shteti? Natyrisht,hapja e linjës se re do të kërkojë shpenzime,po keta s'janë asgjë para fitimit...Linja do ta nxjerrë veten shumë shpejt.Së pari,tregut të jashtëm i afrohet një mall i ri,te cilin ai do ta përpijë.Së dyti,kjo bëhet me një lëndë të parë,që,pothuajse, është falas,si të thuash,një dhuratë e natyrës dhe së treti,rrethit i tërhiqen njëqind krahe të lirë pune...E kupton tani?

Lira – Më vjen mirë për ty,Shkëlqim!

Shkëlqimi – Mos fol në njejës,e dashur mesuese,në shumës dhe ne vetë të parë..E shikon se nuk jam gdhë në gjuhë?Për ne duhet të thuash,se frutat do t'i ndajmë sëbashku!

Lira – A je i bindur,se çdo gjë do të shkojë për së mbari?

Shkëlqimi – Aq jam i bindur, sa ai që shushurit përjashta quhet shi,se po të mos kesh çadër lagesh dhe,se, kjo që pyet,është hë për hë e fejuara ime,ndërsa nesër...(e përqafo)

Lira – Oj,avash,se më theyeve në dysh!..

Shkëlqimi – E meriton,se më ngjalle dyshim...

Lira – Jo, unë kam besim!Po mamaja ime thotë,se përpara t'i fusësh stofit gërshërët,matu disa herë mirë...

Shkëlqimi – Interessant!Ajo mamaja yte qenka kapacitet!(*qeshin*).Pse,ç'më bën ti mua,budalla?I kam hyrë kësaj rruge me ndrojtje,se gjithçka ishte e errët e mund të bija në një pellg...Në fakt,edhe kam rënë,edhe jam lagur,edhe jam ndotur,por rrugën e kam përshkuar deri në fund dhe tani e njoph pëllëmbë për pëllëmbë...Askush s'e ka ditur,as ti...ndaj ka bërë bujë të madhe...

Lira – Vërtetë?

Shkëlqimi – Këmbanat e para i dëgjoi yt atë.Sot ranë të dytat.Uzina vlonte..Dhe e di e ç'bëra? U zhduka nga uzina për të gjithë paraditen,që t'i lija të përvëloheshin nga e papritura,nga

kurioziteti,ndonjerin nga cmira... Po të gjitha i kam marrë vesh,se nuk mund të jesh drejtor i mirë,po s'pate kudo veshë të padukshëm,që të kapin edhe (mikro)ultratingujt...

Lira – Po përse ike?

Shkëlqimi – Ashtu më shkrepì.Edhe për diçka tjetër...Kisha frikë, se nuk do të isha në gjendje t'u fshija syve të vërtetën e asaj ndjenje...Nuk më pëlqen, kur të tjerët përmes syve depërtojnë brenda meje e më shpupurisin ndjenjat..

Lira – (*Ngryses*) Nuk po të kuptoj...Njeriu s' duhet të vejë maskë...

Shkëlqimi – (*Nënqesh*) Ka raste,që duhet,e dashur...

Lira – (E shqetësuar) S'të kam dëgjuar të flasësh ndonjëherë kështu...

Shkëlqimi – Jeta të mësoka shumë gjëra...përshebull,tani mund të them me plot gojën,se kam filluar t'ia njoh vlerat vetvetes...

Lira –(Përpiqet t' i japë ton humori)Avash,avash,se t'u rriten veshët!...

Shkëlqimi – (në të tijën) E ke gabim!Të njohësh vetveten është gjë e madhe!...

Lira – Por jo ta mbivlerësosh...

Shkëlqimi – Aspak!Pesha matet me kandar,vlerat e njeriut me punë. Ç'fatkeqësi,kur punës nuk i plotësohen kërkesat për vlera...

Lira – U bëre interesant ,vazhdo,vazhdo!..

Shkëlqimi – Ta thashë,se kisha dëshirëtë shprehesh me dikë...Është e pamundur t'i nadash të gjitha me vetveten...E më të përshtatëshme se ty nuk mund të gjeja...Do të jesh gruaja ime dhe duhet t'i dish dëshirat e mia...

Lira – Përshebull?

Shkëlqimi – Të marr aq sa më takon!

Lira – Pse?Nuk ka ndodhur kështu deri më sot?

Shkëlqimi – Deri diku...Në këtë aspekt mund të dukem egoist ,po nuk e kam veç për vehte..Punës i duhet gjetur njeriu...Përshebull,si mund të durosh një gdhë,që ke mbi kokë,të të mësojë,të të këshillojë,të të japë urdhëra?Këtu,pra,dalim te maska,që dolëm pak më parë...Duhet t'i buzëqeshësh,t'i tundësh kokën në shenjë miratimi, kur mund t'ia veshësh me pëllëmbë turinjve...

Lira – (*E shqetësuar*) Më e ndershme do të ishte kjo e fundit...

Shkëlqimi – Po jo më e mira! Kjo do t'ri rrëzonte ëndrrat përmbys... Do të të bënte të humbje dhe atë që ke fituar me shumë mund deri më sot...

Lira – (*lutëse*) Nuk ke fituar pak, Shkëlqim... Kafshata e madhe...

Shkëlqimi – (*e ndërpret*) ...në një gojë të madhe nuk ta zë fytin... Po, ti, pse trembesh? Nuk do të kërkoj më tepër se ç'më takon... Por sa më takon, ama...

Lira – Jo, Çimi, nuk më pëlqen, kur të dëgjoj të flasësh kështu... Jemi aq mirë...

Shkëlqimi – Do të jemi edhe më mirë... Në parantezë, s'ke ardhur as edhe një ditë të shohësh shtëpinë.. Bujari po bën mrekullira!

Lira – (*ka humbur*) Ashtu?

Shkëlqimi – E shoh, që je turbulluar, sa të mos thërrasësh nga një lajm i tillë... Ej, thirri mendjes, bëhet fjalë për shtëpinë tonë, që do ta bëjmë aq të bukur...

Lira – (*me ironi*) Që bota të na ketë zili..

Shkëlqimi – Jo, se zilia e tjetrit është me rrezik...

Bie zilja. Hyn Perlati.

Perlato – Më falni!

Shkëlqimi – Urdhëro, urdhëro, Perlat! (*i jep dorën*) Kjo është nusja ime! E njeh?

Perlato – E kam parë... Po të më falni se ju trazova!...

Shkëlqimi – Më vjen shumë keq! (*Lirës*) Perlato e kemi ndër puntorët më të vjetër e më të mirët e uzinës... E kemi edhe komshi... Megjithatë, qysh se më bënë drejtor, është hera e parë, që po me shkel në shtëpi...

Perlato – S'ka rastisur...

Shkëlqimi – Ose ke patur ndrojtje... Po nga unë të druhesh, o Perlat? Mamaja thotë, se një ndër të parë, që na u ndodh pranë, ke qenë ti dhe familja yte...

Perlato – Ç'e kujton atë kohë... Njëzet vjet...

Shkëlqimi – Kishe ndonjë hall?

Perlato – Jo, jo, erdha ashtu kot...

Lira – Po shkoj t’u pjek një kafe...

Perlato – Të faleminderit,sapo e piva...

Shkëlqimi – Atëherë,mos druaj po fol ç’hall ke...

Perlato – Si të them...më vjen zor, që të shklas në derë për një problem timin...Erdha sot në zyrë, po nuk të gjeta...Po ç’të them,ti e di mirë...

Shkëlqimi – Për shtëpinë?

Perlato – Si urdhëron!Më kupto drejt,nuk mban më!...

Shkëlqimi – Ke të drejtë.(Lirës)Të shoqen e ka të paralizuar...Ka ndonjë të re nga mjekët?

Perlato – Asnjë shpresë...Më falni,se iu prisha bsdën...Ç’borxh më keni ju për telashet e mia?!

Shkëlqimi – Hallet dhe gëzimet duhet t’i ndajmë bashkë.Dëgjo,Perlat,herën tjetër u bë si u bë...Këtë rradhë do të jap shtëpi,se s’bën!Rri i qetë!Se s’bën thashë,se të takon...Dhe hiç mos ma di për nder,se ta jep ligji...Ke patur mundësi të bësh ndonjë ditë punë në ndërtesë?

Perlato – Po...

Shkëlqimi – Jo,për gjë, por të mos na dalë ndonjë yçkël, se ti e di se si janë këto punë...Rri,Perlat,pse u çove kaq shpejt?

Perlato – S’mund të rri më gjatë...Lelën e kam në turn të dytë...

Shkëlqimi – Mirë,si të duash...Rri i qetë,dëgjove?Këto ditë do t’i ndajmë. Shtëpinë do ta marrësh se s’bën,sikur nami të bëhet!...

Perlato – Të faleminderit!Dhe më falni,se iu hëngra kohën!...

Shkëlqimi – Më vjen keq që flet kështu,dëgjove?

Perlato – Ditën e mirë!(del)

Lira – Nuk e di,po gati jam t’ia shkep të qarit...

Shkëlqimi – Pse?

Lira – Si pse?Nuk e dallove me ç’zor fliste?Thua se kishte frikë,mos na rëndonte edhe ne...Ai, me siguri që është njeri i mirë...

Shkëlqimi – Po.

Lira – Dhe ç’hall i madh i paska rënë në kokë!...

Shkëlqimi – Një djalë e ka ushtar...E bija punon tek ne me turne...Mund ta kisha rregulluar me një turn, po e bëjnë me rradhe t’i shërbejnë...Herë njëri e herë tjetri...

Lira – (*aludon*) Dhe kur mendon pastaj,si qahemi ndonjëherë kot së koti e s’kënaqemi kurrë...

Shkëlqimi – (nënqesh)Dikujt i bie për hise të vuajë,po kjo s’do të thotë,se të tjerët s’kanë të drejtë të kërkojnë deri në fund lumturinë e tyre të plotë...

Lira – Kërkesat do të rriten gjithnjë dhe ka rrezik,që pakënaqësia të mos na ndahet asnjëherë...Si puna e grykësit,do të thojë,që nuk ngopet kurrë...

Shkëlqimi – Më duket, se nuk më ke kuptuar...

Lira – Ky shi s’paska ndërmend të pushojë...Më jep çadrën tënde!...

Shkëlqimi – (*afrohet tek telefoni*)Alo!Ti je,Besim?Po të moss jesh i zënë,shko merr makinën dhe eja në shtëpi!(*ul dorezën*)

Lira – Për mua e bëre këtë?

Shkëlqimi – Nusja e drejtorit s’bën të laget,se ftohet pastaj...

Lira – Ndoshta Besimi pushonte,ose ishte i zënë me ndonjë punë tjetër...

Shkëlqimi – Ai s’ka punë tjetër...

Hyn Besniku.

Besniku – (shkëlqimit)Më në fund të kapa.Si je Lira?

Lira – Mirë,Niku,si jeni ju?

Besniku – më duket se iu prisha punë!...

Shkëlqimi – (ftohtë) Ulu,ulu!

Besniku – Drejtori qenka në të thella!

Shkëlqimi – Po vras mendjen të bëj përkufizimin e fjalës”shok”...

Besniku – Unë kujtova,se të erdhi keq,pse jam bërë qull...Megjithatë,sikur deshe të bëje një përkufizim..

Shkëlqimi – Po.Përshebull,nuk jam në gjendje të them me saktësi,a duhet konsideruar shok,një që nuk vjen e të thotë copë në sy atë,çfarë mendon për një problem,po të merr në gojë prapa krahëve me njerëz të ndryshëm? Ti si thua?

Besniku – (vë buzën në gaz) Ashtu siç mendon edhe ti:nuk duhet quajtur shok.Për më saktë hap fjalorin e mos e lodh mendjen shumë...

Shkëlqimi – Ja,një këshillë me vlerë!Njeriu në përgjithësi,aq më shumë një kuadër i ri ka gjithëmonë nevojë për këshilla...

Besniku – Pse flet me ironi,Shkëlqim dhe nuk i bie drejtë,se si është puna? Se,që e paske me mua,kjo s’do shumë mend...

Shkëlqimi – Natyrisht,se më shumë të vritka pabesia e atij, që e quan shok të afërt...

Besniku – Nuk e kam për karakter të përfolurin dhe nuk e di ta kem shkelur ndonjëherë në këtë drejtim,megjithatë po të dëgjoj...

Shkëlqimi – Nuk mundje,zotrrote,që, përpara se të flisje me botën,të vije e të më shprehje mua më parë rezervat e tua për intervistën në gazetë?

Besniku – (*qesh lehtë*)Ama,për këtë i paske varur hundët?Megjithatë,kush na qenka kjo botë, me të cilën kam lomotitur për ty?

Shkëlqimi – Viktori...I ke thënë,se ishte një deklaratë më tepër se e guximshme...

Besniku – Ashtu i kam thënë,se ashtu më duket...Po pse,more,botë i thua ti Viktorit?Atë e kemi shok të vjetër pune...

Shkëlqimi – Më parë duhej të ma thoje mua,pavarësisht,janë apo s’janë të sakta ato që mendon...

Besniku – Po s’që ndonjë komplot,more Çimi,që po e bën kaq tragjike...Artikullin e lexova dje në drekë, se dje u botua,apo jo?Hëngra bukë,pushova pak dhe erdha fill këtu..Nuk të gjeta...As sot padreke nuk ishe në zyrë...Pastaj rastësisht takova Viktorin dhe,kur u hap biseda për artikullin,me sinqeritet (e thekson) e pa asnjë paramendim,shpreha ndonjë rezervë...

Shkëlqimi – Konkretisht?

Besniku – Ndoshta edhe gabohem, por më duket se idea për të shtuar linjën e re në një afat rekord,m’u duk pak e nxituar dhe disi më tepër se e guximshme për t’u shpallur në gazetë...

Shkëlqimi – Ashtu mendon?

Besniku – Po.Të ngresh linjë të re në një afat kaq të shkurtër,kur, të paktën duhen disa muaj sa të studiohet e bëhen projektet,pa folur për të tjerat...

Shkëlqimi – Po në qoftëse projektet do të jenë gati,do të tërhiqeshe nga dyshimi yt?

Besniku – Gati?Kush i paska bërë,ti?

Shkëlqimi – Po.Kaq muaj që punoj për këtë ide...

Besniku – Të lumtë!Më gëzove!Po nuk kuptoj,pse e paske mbajtur kaq të sekret?

Shkëlqimi – Se nuk isha i sigurtë në fillim...Vetëm kur u binda,e shpalla...

Besniku – Në gazetë...Nejse...Kjo është puna jote,pak rëndësi ka..E rëndësishme është vlera që kanë projektet...

Shkëlqimi – Vlerën do ta shohim më vonë...

Besniku – Prap kërkon ta mbash monopol?

Shkëlqimi – Do të kesh rast t'i hedhësh një sy...

Besniku – E po mirë,gati më ke ,kur të duash...

Shkëlqimi – Do të pish një kafe?

Besniku – Jo.Më tepër erdha të të them,se sot paradreke të kërkoj në telefon ministria, shoku Klement..

Shkëlqimi – Shoku Klement?Çfarë tha?

Besniku – Nesër në orën tetë duhet të jesh në Ministri...

Shkëlqimi – Je i sigurtë?Dhe më vjen kaq vonë?

Besniku – (*shikon orën*) Nuk është dhe aq vonë..Pastaj dy a tri herë i rashë telefonit,por nuk m'u përgjigj njeri..(*Lira sheh Shkëlqimin*)Përse të kërkon?

Shkëlqimin – Nuk ka të bëjë me uzinën...

Besniku – Atëherë mirëupafshim!(*del*)

Shkëlqimi – Përse më shikon ashtu?

Lira – Nuk u solle mirë me Nikun...

Shkëlqimi – Meritonte edhe më keq...

Lira – Mos i zmadho gjërat! Të tha, si ka qenë puna...Dhe nuk duhet të nxelesh,pse tjetri shpreh një rezervë...

Shkëlqimi – Që mund të lindë nga motive të ndryshme...

Lira – Prap po flet keq!Nikun e njeh mirë....e ke shok të vjetër...

Shkëlqimi – Mbase e shkela pak,por më erdhi inat..Harroje këtë muhabet! (afrohet)E di përse më kërkon shoku Klement?

Lira – jo.

Shkëlqimi – Nuk e merr me mend?

Lira – Jo,pra...

Shkëlqimi – Mirë atëherë,po nuki qetësove vetullat,nuk ta them...

Lira – Si të duash...(bie zilja)

Shkëlqimi – S’na lanë rehat,ta marrë djalli!(hyn Fuati)Aaa,ti qenke?

Fuati – Nuk më prisje?Këtu qenke,Lira?

Lira – Qenke lagur,baba!

Fuati – Kam dalë që në mëngjes...Akoma s’kam vajtur në shtëpi. (*Shkëlqimit*) Kam tërë ditën me peshkatarët, se do të shkruaj një reoportazh...Honorarin e mora paradhënie,mall në natyrë nga familja e peshkut...Ganiu,ai kuzhinieri,shkriu të gjithë talentin e tij dhe, që të mos e zgjas,deri tani u stërmunduam me raki e verë përpara,të cilësisë që ti e di, me shokun Munir...Ç’peshkngrenës që ishte,more burrë!...Naanaa,e thau tavën!...

Shkëlqimi – Pse s’më çove fjalë?

Fuati – Ku kapesht ti!Ju ngjir zëri telefonit brrr,brrr e brrr, brrr në zyrë,po hiç...Megjithatë,që të mos mbetet merak,ta kam ndarë racionin....Edhe më mirë që s’ishe!Në praninë tënd,ndoshta nuk do të ishin bërë ata biseda që u bënë...(pauzë)Artikulli yt i botuar dje ka bërë përshtypje të madhe aty ku duhet...Veçanërisht problemi i linjës së re...Shefi i madh i kishte thënë Munirit,që të merrej personalisht e seriozisht me këtë problem...E kupton, ç’do të thotë kjo? Një në dorë. Edyta,në pije e sipër e në besim,Muniri më tha, se pasi Shkëlqimi të përfundojë atë punë,kushedi sa lart do ta shohë veten...Hë, si thua,bëra apo s’bëra mirë që erdha?

Shkëlqimi – (*Ka humbur*)Ka raste që të mirat të vijnë të gjitha njëherësh!...

Fuati – Edhe nga ti kemi ndonjë të re?

Shkëlqimi – Po.Këtë rradhë nga digasteri.Më kërkojnë urgjent nesër.Më kanë caktuar në një delegacion për në Paris...Më thërasin për dokumentat...

Fuati – E ke ditur dhe s'më ke thënë asgjë?

Shkëlqimi – Ishte e diskutueshme dhe s'kisha pse e bëja bisedë...

Fuati – Tre në dorë!Jepi,jepi dhëndërr, se je në autostradë!Shiko,mos harro një suvenir për shokun Munir!

Bie zilja.Hyn Besimi.

Shkëlqimi – Erdhe Besim?Dëgjo,në orën pesë të jesh këtu,se do të shkojmë në Tiranë.Tani çoji deri në shtëpi Fuatin dhe Lirën!(*Besimi ngryset,po s' thotë asnjë fjalë*)

Fuati – Nuk do ta lagim sonte?

Shkëlqimi – Kur të kthehem...

Fuati-Lira – Natën e mirë!

Dritat

Tabloja e tretë

I njejtë dekor.Lela dhe Donika.

Lela – Nuk po më pyet për punën e re?

Donika – Vërtetë harrova!

Lela – Domosdo,kur mendja veç në një vend...Po mos harro,se edhe kjo ka lidhje me Nikun...Nën drejtimin e tij u bë rikonstrukcioni i repartit...Të ka lezet puna!...E di, që do të kesh për burrë një njeri të zotin?

Donika – Tallu,tallu, se të erdhi dita!

Lela – Vetë më jep shkas. Të isha në vendin tënd, do ta kisha ndarë shapin prej sheqerit... Le që jam e bindur, se edhe ai të do, na kokën time! Po ti je budallaqe!

Donika – Nuk është punë që bëhet...

Lela – Bëhet që ç'ke me të, por, me sa duket, nuk je e vendosur... Mos të ka dalë ndonjë variant më i mirë? Po qe kështu, bëji llogaritë e shih, ku të del më mirë... Donika – Do të më lesh rehat, apço si e ke punën?

Lela – Hiç s'të lë dhe dëgjo: ti vetë më the se mund të vijë sot. Po nuk ia the copë, do t'ia them unë...

Visari del nga dhoma.

Visari – Ç'thonë komplotet?

Donika – E di ç'ke? Më ler rehat edhe ti!

Visari – Mirë, po mos turfullo! Ç'kam faj unë, që nuhas?! Po ti, Lela, ç'më rri si në thumba? Hidhe spirancën!

Lela – Nuk mund të rri më gjatë. Kam nënën vetëm... Ika unë! (*del*)

Donika – Visi, pse nuk flet me Çimin? Këta kanë nevojë urgjente për zgjerim.

Visari – Pse nuk e di ai? Dy hapa larg e kanë shtëpinë... Babë e bijë i ka në uzinë...

Donika – Sidoqoftë, thuaja një fjalë!..

Visari – Unë? Mua më ka në majë të hundës, ti në bëfsh gjë, se ty ta solli një shami hundësh nga Parisi... Helbete, motër e vetme!... Po të paktën Bujarit t'i sillte një çakmak! Po i bie bretku në punë, të ngratit! E di, si ia ka patinuar shtëpinë? Ta lëpish me gjuhë! Edhe korridorin po ia shtron me granil... Çfarë s'po bën në atë shtëpi! Po Bujari është Bujar, ç'i thuash atij? Ku dreqin u hap kjo bisedë, se m'u ngriten nervat! (*matet të dalë*)

Donika – Prit, ku shkon? Pas pak do të vijë Niku!...

Visari – E pastaj?

Donika – Hiç, rri edhe ti...

Visari – Jo, do të dal pak, se kam punë.. Nuk vonohem.. (*del.*)

Donika sillet nëpër dhomë. Nuk është e qetë. Bie zilja. Niset me të shpejtë. Hyn Bujari.

Donika –A,ti qenke!

Bujari – Pse,kë prisje,zotrrote?

Donika – Askënd...Po ti nuk i ke rënë ndonjëherë ziles...

Bujari – Kam bërë gabim...(ulet në divan i lodhur dhe mrr frymë thellë)

Donika – Qenke lodhur!

Bujari – Pak.Çimi këtu është?

Donika – Jo,në një mbledhje...Po ti prite,se tani mund të vijë...

Bujari – Nuk kam kohë...Ku shkon?

Donika – Të të bëj një kafe...

Bujari – Ku di të bësh kafe ti!Nënë Tana po...Më ka marrë malli...U ngul te Gramozi e s’po di të shkulet...

Donika –Këto ditë vjen...Mirë,atëherë,meqë s’ do kafe,po të sjell diçka,që s’do të ma kthesh...(shkon te frigoriferi e sjell një ëmbëlsirë)

Bujari – (E ha me të shpejtë)Kush e paska bërë?

Donika – Unë,si t’u duk?

Bujari – Çka!Shkova unë,se nuk e kam lënë mirë Lumen...

Donika – E mbyte vehten,ç’bën kështu?Edhe për Lumen është e rëndë!

Bujari – Ja edhe pak ditë e i jap fund...Një Çim kemi,ta marrë e mira!...

Donika – Po unë të dija vetëm motorist ty,kurse Visari më tha,se ke bërë mrekullira...(sheh orën)

Bujari – Mos më fol për libra mua,pa për punë,ahuha!Aq më tepër kur e bëj me qejf!Për kokën e çunit, kur të martohesh ti,kushedi ç’do të sajoj për dhuratë, që të lozin mendsh dynjaja!...Ja marrtë të keqen babi!

Donika – Kujt?

Bujari – Djalit,pra!Edhe pak ditë e pres!Do të bëj një banket deri në gju.Do të të bëhem tapë,atë natë...Edhe Çimin do ta deh...Pastaj të dy do të vijmë si sarahoshë mejhanesh e do të këndojmë një serenatë...Po të thuash ti, e marrim edheNikun,se këndon bukur!..Apo të mos e marrim më mirë, se është një zemërpulë,që nuk e ka shokun e po na bën ndonjë budallallëk... Dale,moj,mos i var turinjtë,se s’po ta shaj!Nejse,po iki!T’ i thuash Çimit,se korridori nuk përfundoi sot,se më mungoi çimentoja e bardhë.E more vesh? Dhe mos më mbaj inat,se e sheh pastaj!... (gati përplasjet me Besnikun,që hyn)Ja,përmend Besnikun e bëj gati shkopin...Ty të kishim në gojë...Po më thoshte Donika,se je një zemërpulë që...Ika unë, se u bëtë dy tani e, me siguri,do të më shani me mend,po të rri prap...

Besniku – (rreptë)Bujar!

Bujari – Po pra,ju jeni me shkollë të lartë e,kushedi,ç’probleme shkencore keni për të zgjidhur...Hajt shëndet e guxim!...(del)

Besniku – Shkëlqimi ku është/kisha për t’i dhënë skicat...

Donika – E thirrën në një mbledhje...Më tha ta presësh...

Besniku – Nënë Tana si është?

Donika – Mirë...Te Gramozi...

Besniku – Ashtu?Ka kohë?

Donika – Dy javë...

Besniku – Nuk më ka thënë gjë Çimi...megjithëse e kam pyetur për nënën..

Donika – Kushedi,megjithëse,po të kishe ardhur vetë apo të kishe marrë në telefon,do të të kisha treguar unë ose Visari...

Besniku – Ke të drejtë!Mund të kisha marrë në telefon...

Donika – Pse mos ta ka ndaluar njeri ardhjen?

Besniku – Kam qenë shumë i zënë...

Donika – E di.Urime për repartin!

Besniku – Faleminderit!Ta paska thënë Çimi?

Donika – Ai apo ndokush tjetër...Unë kam qenë më pak e zënë,kështu që kam oatur kohë të interesohem edhe për telashet e shokëve(e thekson) të vëllait...Natyrisht vetëm për telashet e punës...

Besniku – Sa mirë do të ishte të ruheshin gjithmonë të pastra këto raporte...E kam fjalën,që të mos përlyheshin kurrë...

Donika – Në ç' drejtim përshembull?

Besniku – Po,ja,sikur ta zëmë,unë t'i jepja në besë një shoku çelësin e shtëpisë e ai të më merrte,pa më thënë,qoftë edhe një libër...A duhet të kem besim prap tek ai?

Donika – Vjedhja,e madhe apo e vogël qoftë,se kështu duhet quajtur edhe rasti në fjalë,është krim dhe krimin e denojnë të gjithë...Ashtu siç është krim,natyrisht,i njëlloji të veçantë,kur tjetrit i premtom t'i tregosh rrugën për diku dhe pastaj e le në mes të rrugës...

Besniku – Unë nuk i kam premtuar kujt...

Donika – Me keqkuptove...Ashtu si ti,edhe unë fola në përgjithësi... Megjithate,premtimi apo diçka më shumë se premtimi,ka raste që jepet jo vetëm me fjalë,më kupton?

Besniku – Të kuptosh nuk është shumë vështirë...Të flasësh të kundërtën e asa, që dëshëron,është më e vështirë...

Donika – Dhe pse duhet bërë kjo sakrificë?

Besniku – Se njeriu mund të ketë dëshira,por ka edhe detyra...Nganjëherë për hir të detyrës duhet sakrifikuar dëshira...

Donika – Kisha menduar,se të njoh mirë...Por kohët e fundit,e veçanërisht sot,zbulova se qenke filozof,por disi anakronik...Një filozof anakronik me shpirt të theksuar sakrifice!...Të lumtë!...

Besniku – Donika,duhet të më kuptosh...

Donika – Të kuptova shumë mirë...Po faji është i imi,që lajthita në këtë moshë...

Besniku – Jo,imi,që nuk u tregova më i matur në marrëdhënjet me ty. Të më falësh,meqenëse i lamë filozofitë!...

Donika – (ftohtë)Për çfarë?

Besniku – Se ka patur raste,që unë harroja,se nuk ishe më e vogël si dikur, se nuk e kam frenuaer veten dhe kam dalë disi jashtë marrëdhënjeve,që kisha krijuar me ty,qëkur ishe fënijë...Duhej të

të kisha konsideruar gjithmonë si motrën e shokut...

Donika – Pse unë nuk e dija,se duhej të të mendoja gjithmonë si shokun e vëllait?Po ç'kujton ti,se zemra është një sahat që e kurdis, kur të duash e si të duash?

Besniku – Kur e kuptova këtë,shpresova, se ishte vetëm për mua,kështu që u përpoqa ta shtyp atë ndjenjë, që kishte lindur paparitmas...Dhe do ta kisha shtypur,sikur të mos shihja,se kjo nuk ishte e njëanëshme...Prandaj fillova të mos vij,me shpresë se qeshë gabuar dhe, kur të vija një ditë,në sytë tuaj nuk do të dalloja atë që nuk e dëshëroja...Të fola hapur,se nuk mund të gënjej dhe sepse ti e meriton këtë...Kurrë nuk kisha dashur të hapej kjo bisedë,po gjithçka të fikej vetvetiu...Por,ndoshta,më mirë që ndodhi kështu...Më tepër për ty...Donika,a mund të më quash tani e tutje vëlla,si dikur?

Donika – E pse duhet ta bëj këtë?

Besniku – Që të mos e ndjej veten besëthyer ne marrëdhënje me Shkëlqimin ...në marrëdhënjet me këtë shtëpi të mirë...(pauzë)

Donika – Ti mendos,se kjo është zgjidhja më e mirë?

Besniku – (me gjysëm zëri)Po...

Edhe unë ,atëherë,do të përpiqem,megjithëse jam e bindur,se ky pallat i bukur po shembet vetëm e vetëm pse arkitektët i paskan bërë një ballkon disi të veçantë dhe se dikush mund të thotë: u prish planimetria!...

Hyn Visari.

Visari – Hë,Niku,ç'kemi?

Besniku – Mirë,Visi,si je?

Visari – Dhjamë!

Besniku – (ngrihet)Po shkoj,se u bëra vonë...I solla Shkëlqimit projektet...I ka

Donika..Ai,ndoshta,vonohet...

Visari – Shkëlqimi erdhi!Donika,ku ma ke lënë librin?

Donika – (shkon dhe e merr në njërin nga divanët dhe ia jep)Ja,ku e ke...

Visari – Thonë,se nuk është keq të pasurosh shpirtin me letërsi...

(ulet në divan e fillon të lexojë.Vjen Shkëlqimi)

Shkëlqimi – Hë,Besnik,më ke pritur gjatë?

Besniku – Nuk ka shumë që erdha...

Donika – Ishte edhe Bujari...

Shkëlqimi – E paska mbaruar korridorin?

Donika – Jo,i ka munguar çimentoja e bardhë.

Shkëlqimi – Po,pse,tani kujtohet për çimento?E ku ta gjej sonte?

Donika – Sonte nuk mund të punonte më,se Lumen e kishte pa qejf...

Shkëlqimi – (nënqesh) Epo, prandaj paska munguar çimentoja... Nejse... (shkon te telefoni dhe merr një numur) Alo! Ti je,Besim?Dëgjo këtu!Tani është ora shtatë.Llogarite kohën ,sa të duhet

për të shkuar deri në uzinë, ndiz makinën dhe në tetë të jesh këtu në shtëpi....Mirë?(*mbyll telefonin*) (*Besniku*)Që thua ti,as që e kisha llogaritur të dal mbasdite...Po të lë tjetri të shplodhësh eshtrat?Shkon e të del papritur një mbledhje jubilarë e ec e mos shko...M'u qep shoku Munir,po e dija si t'i bëja bisht..Kështu që tërë pasdrekja aty...S'kisha as s'i ikja,për dreq,se isha në presidium...

Visari – (*lexon*)Lavdia e tepërt është me rrezik...

Shkëlqimi – (*nxehet*) Si the?

Visari – Jo unë,po Eskili...Gabimisht e lexova me zë!Njeri i madh ka qenë dhe,kur e mendon,se e ka thënë këtu e dymijë e pesëqind vjet më parë...

Shkëlqimi –Nuk ke vend tjetër, ku të lexoh Eskilin tënd?Shko matanë,se kemi probleme pune...(Visari nderon me grusht dhe del në dhomën tjetër me Donikën.)Hë,ç' mendim ke për projektet?

Besniku – Ke punuar me shumë kujdes dhe saktë...Më duket se çdo gjë është në vendin e vet...

Shkëlqimi – (*tund kokën i kënaqur*)Unë e di sa netë pa gjumë kam kaluar mbi to...Ta diskutojmë sa më parë në këshillin shkencor...

Besniku – Mendon,se është gati për ta hedhur në diskutim?

Shkëlqimi – Sa më parë...Çdo minutë e humbur është në dëm të ekonomisë...Shteti ka nevojë për valutë dhe është detyra e të gjithëve të bëjmë ç'është e mundur e me të gjitha forcat...Duhet jetuar më mirë me situatat,inxhinier Besniku!E kupton,pse duhet ta bëjmë sa më parë linjën e re?

Besniku – Si urdhëron,shoku drejtor!Nga kjo mbledhje mesova ca gjëra,që nuk i dija...

Shkëlqimi – Pa ironi,inxhinier!...

Besniku – Mirë,mirë,le të flasim më thjeshtë...Të gjitha këto, që the,i kuptojmë,por pse matesh mirë,nuk ka asgjë të keqe..

Shkëlqimi – Ku e ke fjalën?

Besniku – Po ja,përshembull,a i ke bërë analizat e lëndës së parë, me të cilën do të prodhohet malli?

Shkëlqimi – Natyrisht,që i kam bërë!...Pse,ç'më di ti mua?

Besniku – Nuk të hëngra,pse të kujtova diçka,o Çimi.Pse flet kështu?Të pyeta,se ndonjëherë nga kënaqësia e punës apo nxitimi harrohen ca gjëra elementare...Ç'të keqe ka këtu?Ti i paske bërë,shumë mirë!E rëndësishme është,që mali të çajë tregun e jashtëm...

Shkëlqimi – As që e vë në dyshim!...E di mirë,se ç'kërkon tregu i jashtëm,se pata fatin ta shoh edhe me sytë e mi...

Besniku – A kishte kampione të këtij malli nga të tjerët?

Shkëlqimi – I yni s'do t'u lërë gjë mangut,përkundrazi...

Besniku – Ashtu qoftë!(*matet të thotë diçka por hesht*)

Shkëlqimi – Ke ndonjë pyetje tjetër?

Besniku – (*vë buzën në gaz*)Jo,jo...

Shkëlqimi – Thuaje,mos të të mbetet merak!

Besniku – Jo,se,me siguri,dihet ta kesh bërë...

Shkëlqimi – Çfarë?

Besniku – Ballafaqimin me literaturën botrore...

Shkëlqimi – *(me nxitim)*Po,po natyrisht...

Besniku – Shumë mirë,atëherë..Suksese!Natën e mirë!(del)

Hyn Donika

Shkëlqimi – Eja,Donikë,ulu!

Donika – Besniku shkoi?

Shkëlqimi – Po...E di ti, që i është rritur mendja shumë?Po më fliste si profesor...Po unë e di,pse e bën këtë...

Donika – Pse?

Shkëlqimi – I kam zënë udhën...

Donika – I ke zënë udhën?Ç' udhë i ke zënë?

Shkëlqimi – Edhe ai ka qenë kandidat për drejtor...

Donika – Mbase gaboresh,Çimi...Nikun e ke shok të vërtetë...

Bie zilja.Hyn Besimi.

Shkëlqimi – Erdhe,Besim?Kishe ndonjë plan sonte?

Besimi – Jo.

Shkëlqimi – Shko shpejt deri te Vani,ai i monumenteve të kulturës...I thuaj, se kam nevojë për një thas çimentoje të bardhë...Kundrejt pagesës,natyrisht...Në shtëpi e ke...Shkoni merrni çimenton dhe çoja Bujarit...Mirë?E dyta,si je me benzinë?

Besimi – Keq.

Shkëlqimi – Për nesër serbatorin ta kesh plot,gjeje ku të mundesh...Me vjen një shok me rëndësi e dua t'i bëj një surprizë...Ke gjuajtur lepuj ndonjëherë?!

Besimi – Jo.

Shkëlqimi – Kështu,pra,u morëm vesh!...

Besimi – S'kam,ku të gjej naftë...I kam harxhuar të gjithë fishekët!...

Shkëlqimi – Besim,kjo nuk është lutje,kupton?

Besimi – Atëherë edhe unë po ju them,shoku drejtor,se këtë urdhër nuk do ta zbatoj...Se,tek e fundit,unë jam punëtor e jo shërbëtor...

Shkëlqimi – *(i befasuar)*Çfarë?

Besimi – Unë fola qartë...Dhe jo vetëm për këtë rast,por sa herë urdhërat do të jenë për probleme personale...Jam matur edhe herë të tjera,po kisha menduar,se nuk so të bëhej rrugë...

Shkëlqimi – *(nënqesh)*Ke të drejtë,Besim!

Besimi del me të shpejtë.Në dalë dalë gati përplaset me Fuatin.

Fuati – Ngadalë,ngadalë,se bëre karambol!...*(Besimi nuk i kthen përgjigje)* Ç'kishte ky,që iku si urgjencë?

Shkëlqimi – Kokën e vet do të hajë,siç ia ka nisur!...

Fuati – As muna s'më pëlqen...Sa herë më ka rastisur të udhëtoj me të,tërë hundë e buzë,a thua, se më kishte rëndë...Jepi duart!

Shkëlqimi – Eja,ulu!

Fuati – Nuk do të rri gjatë.Kur i ndani shtëpitë?

Shkëlqimi – Këto ditë,pse?

Fuati – Një hyrje veçoje për mua!

Shkëlqimi – Për ty?Ç'hyn ti në këtë mes?

Fuati – Përdersa kam ardhur,do të thotë, se hyj...

Shkëlqimi – E kam të vështirë,projekti është bërë...

Fuati – Një drejtor i fortë e çbën...

Shkëlqimi – E çbën,po nuk kam dëshirë të më përgojnë...Të gjithë kandidatët janë nevojtarë...

Fuati – Edhe rasti im është brenda kritereve.

Shkëlqimi – Po kush qenka ky,xhanëm,që paska kaq forcë?

Fuati – Më parë më jep fjalën...Shtyhu një herë për tët vjehërr...

Shkëlqimi – Kam dhënë prova...Për hatrin e Petros,mikut tënd,që e vunë aty,ku s'e meritonte,e kam ngrënë një vërejtje në organizatë...Po më vë në pozitë...Po,të paktën, të di,se kush është...

Fuati – Sadoja,marangozi...

Shkëlqimi – Sadoja?Po ty ç'të lidh me Sadon?

Fuati – Një bibliotekë gratis për shtëpinë tënde të re...

Shkëlqimi – Si?!

Fuati – Me rimeso arre dhe sa dy faqe muri...

Shkëlqimi – Fuat,eja në vetë!Si mund të ma thuash këtë fjalë?Kurrë me atë rrugë...Dhe,të lutem shumë,mos ma zer më me gojë këtë problem,më kuptove?

Fuati – E ke me tërë mend?

Shkëlqimi – Po...Dhe nuk arrij të kuptoj,se si munde të ma bësh një propozim të tillë!...Nuk e di ti ,se ç'emër mban kjo?

Fuati – Ngadalë,ngadalë,se nuk je në mbledhje...Dhe qetësohu!Mendova, se po të zgjidh një problem...Nuk e do bibliotekën,mirë,mos e merr!Por shtëpinë Sados do t'ia japësh...Këtë ta kërkoj unë...Kam një arsye personale...(pauzë)Po pres përgjigje!...

Dritat

Paraskenë

Besniku del nga zyra mendueshëm.Ndez një cigare dhe ulet në një stol diku në cep.Donika kalon aty pranë.E dallon Besnikun,po bën sikur nuk e sheh.

Besniku –*(e sheh dhe ngrihet insinktivisht)*Donika!

Donika – *(ftohtë)* Më fal,s'të vura re!..

(Besniku – *(i jep dorën)*Si je?

Donika – Si duhet të jem sipas normave dhe parimeve të tua?Po thanë mirë ata,mirë do të jem...

Besniku – Më mban mëri?

Donika – *(ironike)*Mëri?Aspak!Nuk më ke lënë shakas ndonjëherë...Në shtëpi ke hyrë e ke dalë korrekt,brenda të gjitha rregullave të mërësjielljes dhe edukatës...Ke gëzuar respektin e të gjithë pjestarëve të familjes...

Besniku – *(me shaka)*Faleminderit!Nuk e dija,se mund të më bëhej një karakteristikë kaq e mirë...

Donika – E meriton...Dhe rrugën e ke të hapur...Trokit tani në cilën portë të duash...Jam e sigurtë,se nuk do të të kthehet dora...Besoj,se edhe ti ndan të njejtin mendim me mua,apo jo?Sa më shpejt ta bësh këtë,aq më mirë do të jetë...

Besniku – E thua sinqerisht këtë?

Donika – Po...Motra e shokut gëzohet gjithmonë për shokun e vëllait,kur ndien diçka të mirë për të... Ti e vë këtë në dyshim?

Besniku – *(si i përhumbur)*Si është nënë Tana?

Donika – *(shpejt e pa pauza në mes)*Nëna është mirë..Ka dy ditë që e sollti Gramozi,që gjithashtu është mirë...Edhe atje në malësi të gjithë mirë janë...Visari është turn i tretë dhe flë gjithë paradreken...Unë jam krejt mirë.. Shkëlqimin e sheh përditë,s'kam ç'ë shtoj për të...Të gjitha orenditë e shtëpisë janë në vend,siç kanë qënë, perveç një vazoje, që u thye dje...E theva unë...

Besniku – Informacion i saktë,që nuk të lë shkas për pyetje të tjera...

Donika – Kështu që unë jam e lirë të vazhdoj rrugën...

Fuati hyn në skenë.

Fuati – *(i qeshur)*Ou,mirëmbërëma,mirëmbërëma!

Të dy – Mirëmbërëma!

Fuati – Natë e bukur sonte,apo jo?Shumë mirë,shumë mirë!

Donika – *(me mllëf)*Edhe ne atë po thonim!...S'po na bëhet të shkojmë në shtëpi...

Fuati – Pse të shkoni?Heret është!...*(Besnikut)*Shkëlqimin e ke parë?

Besniku – Po..S'ka pak që u ndamë...

Fuati – E bëtë mbledhjen e Këshillit Shkencor?

Besniku – Po.

Fuati – Si përfundoi?

Besniku – U miratua.

Fuati – Domosdo që do të miratohej...Ika unë,s'jam rini si ju!Natën!

Të dy – Natën!

Donika – A mund të largohem? Kushedi kush tjetër mund të na shohë e s'është mirë t' u japim shkas të flasin kot së koti...Jo për gjë,por thyhet opinioni i mirë,që mund të kenë krijuar për ty...

Besniku – Edhe për ty..

Donika – Pak rëndësi ka...

Besniku – *(matet të thotë diçka)*Donika...

Donika – Natën e mirë!*(ikën me vrap.)*

Besniku ulet në stol dhe ndez një cigare.Ka rënë në mendime. Hyn Bujari.

Bujari – Ej,mor çun,mos të kanë humbur dhitë?

Besniku – Oh,Bujar,sa mirë!

Bujari – Ç'je zverdhur kështu?

Besniku – Kam pirë shumë duhan...

Bujari – Unë kujtova se ç'ke!Mirë të të bëhet!I ngop mushkритë me kushedi sa metër kub nikotinë e mua më ngrin gjakun...Eja tani të të nduk një copë faqe!

Besniku – *(ende i turbulluar)*Mua?

Bujari – Ty,more guak,ty!Se mjaft je tallë me mua...

Besniku –Jam tallur?Për çfarë?

Bujari – Ohuha!Këtij sikur njëdash po i del narkoza...Ej,mos të kanë hequr gjë apendecitin?

Besniku – Kisha menduar,se kam vullnet të fortë,Bujar...po paska gjëra ndaj të cilave rezistenca sa vjen e dobësohet...Dhe nuk di ç'të bëj...Si në një udhëkryq...

Bujari – More,mos më fol me të holla,po bjeri troç!

Besniku – *(sikur përmendet)* Sikur deshe të më puthje?

Bujari – Jo,pa m'i zbrazur të gjitha...

Besniku – Gjera pa rëndësi...

Bujari – Mirë,atëherë,edhe unë kot po të them,se jam shtuar me vajzë...

Besniku – Vajzë?Me jetë të gjatë!

Bujari – Djalë,more tutkun,djalë!Tre e tetëqind!*(përqafohen)*Dëgjo,sonte eja me mua!

Besniku – Jo,se nuk dinë gjë në shtëpi...

Bujari – I lajmërojmë...Dhe mos e zgjat!Mos kujto,se të marr për burrë të mirë,por që të m'u gatuash ndonjë gjë të shijëshme vajzave,se të vjen doresh... Rri pa frikë,se edhe po të duash,sonte nuk të jap me shumë se dy gota raki...Jo,për gjë,po thonë se rakia të bjen në kokë,kur pi duhan shumë.. Rakinë do ta lemë për pasnesër!...Hajde,tash,jepi marshit!

Dritat

Tablo e katërt

Shtëpia e nënë Tanës. Dy ditë më pas. Është mbrëmje vonë.

Tana – Mos u mërzit, moj bijë!.. Kushedi si e ka patur punën...

Lira – Jo, nënë, për sonte ai duhej të linte çdo punë...

Tana – Ashtu është, po kushedi... Fuati erdhi djhe e mori... Diçka biseduan dhe ikën... Më tha ta prisje...

Lira – Nuk bëhej qameti, po të mo s dilte... Bujari na pret!.. Ai ka gëzim... Dhe sa ka bërë për ne!

Tana – Po erdhi tani shpejt Visari nga puna, shkoni bashkë... Ose shkoni me Donikën! Donika – Jo, më dhemb koka. Pastaj Bujari pret Shkëlqimin e jo Donikën!..

Tana – Ai na ka ftuar të gjithëve, po s' mund t'ia mbushnim shtëpinë!

Donika – Bujari ka bërë të tijën, po ne vijmë pas Shkëlqimit... Nuk i falet!

Tana – Ku di, ç'të them, e shkreta...

Lira – Të paktën, të më kishte telefonuar... Nuk di ç'të bëj... Të shkoj në shtëpi, apo të pres...

Tana – E di ç'ke ti, pa ulu e ha një kafshatë bukë njëherë!..

Lira – Nuk më hahet... *(Tana e përkëdhel)*

Tana – Gjëra që ngjasin, moj bijë, mos u mërzit!

Lira – *(gati sa s'qan)* Jo, mama, se s'lihet tjetri të presë tri orë... Po nuk është puna vetëm aty... Unë mezi ç'kam pritur të shkoj.. Bujari është aq i mirë!...

Tana – Flori është...

Hyn Shkëlqimi.

Shkëlqimi – Mirëmbërëma! *(Donika hyn në dhomë)*

Tana – Mirë se erdhe! Ç'u vonove kështu?

Shkëlqimi – Më doli një punë... *(shikon orën)* Eja të shkojmë!

Lira – Ku të shkojmë?

Shkëlqimi – Te Bujari, pra...

Lira – Pse shkohet tani në njëmbëdhjetë të natës?

Shkëlqimi – Ç'të keqe ka?

Lira – Ka, se tani është, sa për të kaluar radhën... *(Tana del)*

Shkëlqimi – Si të duash dhe mos i fut shumë zor vetes, se nuk ra Troja!... Me Bujarin rregullohem nesër...

Lira – Ti e ke fyer Bujarin..

Shkëlqimi – Po më doli një punë, pra, ta marrë dreqi!

Lira – Për sonte s' duhej të lije asnjë punë!

Shkëlqimi – Të t'i heq kacabujtë? Ia vlente të vonohesha!...

Lira – Nuk priste për nesër?

Shkëlqimi – Ohu,ç'më çan kokën!

Lira – Si the?

Shkëlqimi – Po më pyet si në hetuesi,prandaj..

Lira – nuk ta kisha borç atë fjalë,por të falet,se paske pirë...

Shkëlqimi – Yt atë e ka fajin dhe shoku Munir...Ata më mbajtën me zor deri tanë...

Lira – T'u kishe thenë, se kishe një punë...Le që babai e ka ditur...

Shkëlqimi – Domethënë,sipas teje,t'i thoja shokut Munir,rrri ti,vëlla,se, natyrisht, me ty shihem përditë,pasi,edhe për të pirë kemi pirë shpesh bashkë,jo për gjë, po me duhet të shkoj te një person i një rëndësie të veçantë,meqë është hera e parë në,që më jepet rasti e nuk e di,a kam fat tjetër ndonjëherë në jetë...Kështu?

Shkëlqimi – Ti po e rëndon fajin ndaj Bujarit...Atë kurrë nuk duhej ta shisje aq lirë,qoftë edhe për shokun Munir!...

Shkëlqimi – Moj,ase po të dëgjoj pak si shumë!Nuk të jap llogari, se me kë shkoj,dëgjove?Nuk je bërë akoma,zotrote,të më japësh mend...Dëgjove? Budallaçkë!...

Tana hyn me të shpejtë.

Tana – (*ashpër*)Shkëlqim!Si i flet vajzës kështu?

Shkëlqimi – Më fal,e teprova...

Tana – Pak më parë dola, që t'u lija ti zgjidhnit vetë punët tuaja,por jo të ziheshit...Dhe nusja ka të drejtë!

Shkëlqimi – E po mirë,pra,se nuk u bë qameti!Që të lahem me Bujarin,po ia dyfishoj dhuratën...

Tana – Ç'thua,more,kështu?Po ai s'ka nevojë,more,për paratë e tua,as për dhuratat e tua...Ai ka nevojë për shoqërinë tënde,që sonte ia mohove...

Lira – Jo vetëm sonte...Ka disa kohë,që s'ka pirë një kafe me të,që s'i ka kushtuar dhjetë minuta kohë,për t'i thënë një fjalë të mirë...Natyrisht, kur syri godet lart...

Shkëlqimi – Si the?

Lira – Të është rritur mendja,Shkëlqim..Sonte po ta them në prani të nënës. Edhe tk unë nuk sheh shoqen e jetës,po një çupërlinë,që ke për etyrë t'i mësosh rrugën,se,helbete,di më shumë,kupton më shumë,të bie rasti të rrish me shokë të lartë,të japësh intervista e të jesh në presidium...Një gjysëm kritike të të bëj,kërcen përpjetë dhe të fyen...Po unë nuk ta lejoj një trajtim të tillë ...Dëgjove?

Shkëlqimi – Kishe gjë tjetër për të thënë në sy të nënës?

Tana – Nëqoftëse është si thotë nusja,mblidh mendjen dhe...mos e shiko,sikur do ta hash,se unë jam nëna jote,nuk jam e huaj... Hajde,mjaft tani!(*Lirës*) Lajmeroi prindërit e rri nga ne sonte...

Lira – Jo,mama,po shkoj...

Tana – Si të duash...(Shkëlqimit)Po të pres,sa të kthehesh...

Shkëlqimi – Kjo nuk është çupërlinë, mama...Nuk ka nevojë, që dikush t'i tregojë rrugën...E gjen vetë...

Tana – Bëj si të them unë...

Lira – Nuk është nevoja..(*përqaqfon Tanën*)Natën e mirë!(*del*)
Tana – Ti meriton një shpullë!...
Shkëlqimi – Ndoshta duhej të shkëja,po rrogës prap do të ishim zënë...Le t'i bëjë më mirë hesapet në qetësi...
Tana – Po si të shkon në mendje,more,një gjë e tillë?Ajo është një vajzë e rrallë...
Shkëlqimi – Po,ja,është e pakënaqur...
Tana – Shkakun ta tha në sy e ti duhet të mendosh mirë...
Shkëlqimi – Nuk është e vërtetë..Ajo foli e zemëruar..Posi,më qenka rritur mendja!Po,natyrisht, se ti e di më mirë se kushdo tjetër, se kur të vij në shtëpi!...Ditë natë në punë..më ranë brinjët!Pse të mos më rritet mendja!

Hyn Visari.

Visari – Ule,ule zërin,se dëgjoresh te dyqani i bukës!
Shkëlqimi – Erdhe edhe ti të më japësh mësim?
Visari – Pse,ç'kishe orën e parë,edukatë morale?
Shkëlqimi – Do ta mbyllësh gojën,apo si e ke hallin?
Visari – Mirë,mirë e mbylla, po mos bërtit!
Tana – Ejani të hani bukë!
Shkëlqimi – Unë nuk dua!
Visari – Kushedi si ta ka shtruar Bujari sonte,prandaj...Më erdhi keq që isha turn i dytë...U kënaqët?
Shkëlqimi – Natën e mirë!(ngjitet lart nepër shkallë)
Visari – Pse ishte me miza ky?
Tana – Ha bukë,se je lodhur...
Visari – Po s'më the ç'kishte,nuk ha...
Tana – Hiç,asgjë,rri tani...
Visari – Të lumtë,nënokë,di ta ruash sekretin dhe këtë e bën për harmoninë e djemve...(Ngrihet dhe puth)Me ke ishte zënë?
Tana – Me Lirën,dreq!...
Visari – Të lumtë,Lira!Po pse?
Tana – Se mbeten pa shkuar te Bujari...
Visari – E dija.Për kokën tënde,që e dija...Me siguri ndonjë mbledhje me bërçolla përpara,se ia ndjeva erën...Me ndonjë të digasterit,apo të rrethit?Apo tek për tek me të vjehrrin?Se i shkojnë shumë njeri tjetrit sipas midesë...Zaten ai ia kreh bishtin!
Tana – Do të hash,apo si e ke punën?
Visari – Ah,more Bujar,t'i krypshta trutë!(*zilja*) Po tani kush do të jetë?

Hyn Bujari me një trastë në dorë.

Bujari – Mirëmbërëma!(përfaqon Tanën)

Tana – E paç me jetë djalin dhe gjithë ç'ke,o Bujar!

Visari – Ja,tani sapo erdha,po do ta kisha tharë një gjysëm kile raki...

Bujari – Ta kam sjellë...(nxjerr nga trasta një shishe) Ja,edhe mezet!...Ja edhe ëmbëlsirat!...(Tanës)Këto janë për ty e Donikën!(nxjerr një pako tjetër) Këto janë për Shkëlqimin e Lirën...Nuk ka ardhur akoma?

Tana – Lart është...

Bujari – Çfarë ka,nuk është mirë?

Tana – Jo,mirë është....sapo u shtri...Prit,se po i bëj zë...

Bujari – Nuk ka nevojë...Unë mendova,se mos ishte i sëmurë,apo i kishte dalë ndonjë punë....M'u zu në fyt gëzimi,nënë Tana!...

Tana – Gëzime paç gjithmonë ,more bir!Pa të tjerat rregullohen...

Bujari – Ma bëni hallall!...

Tana – Për çfarë, o Bujar?

Bujari – Se ju kam bërë zhurmë ndonjëherë...Shtëpinë time e keni të hapur gjithmonë,njëlloj sikur të isha Gramozi apo Visari...

Tana – Prit,Bujar,ku shkon?

Bujari – Naten e mirë!(del)

Dritat

Tablo e pestë

Injefti dekor.Tana merret me punë.Bie zilja.Hyn Besimi.

Tana – Urdhëro,Besim!

Besimi – (është i zverdhur në fytyrë) Më ka kërkuar drejtori...Sot nuk kam qenë në punë...

Tana – Tani vjen.Po ti ç'paske kështu?

Besimi – M'u morën pak mendtë...

Tana – Eja,ulu!Ja,po të bëj shpejt një kafe...

Besimi – Ju faleminderit!Nuk është nevoja...

Tana – Ç'është ajo fjalë!Shiko si je zverdhur në fytyrë!(Del me të shpejtë)

Hyn Shkëlqimi.

Shkëlqimi – Paskë ardhur?Ç’pate që s’dole sot në punë?

Besimi – Nuk u ndjeva mirë...

Shkëlqimi – Tani si dukesh?

Besimi – Mezi erdha...Keni ndonjë plan?

Shkëlqimi – Nesër në orën tetë duhet të jem në Ministri.Eja më merr në mengjes heret...(Besimi ul kokën)

Besimi – Ju thashë,që nuk jam në gjendje...Nuk di se ç’kam...Mjeku sot nuk përcaktoi asgjë...E kemi lënë që nesër të bëj analizat dhe një skopi...

Shkëlqimi – Hëm,po si t’ua them atyre të Ministrisë,se nuk erdha,se kisha shoferin sëmurë?

Besimi – Jo,mund të gjeni një rrugë tjetër...

Shkëlqimi – Të gënjej?Ti je parimor,Besim,si të shkon mendja në një gjë të tillë?

Besimi – Unë nuk thashë këtë...unë mendova,se mund të gjindej një rrugë tjetër...

Shkëlqimi – Mos duhet të shkoj me tren?

Besimi – As kjo nuk më shkoi ndërmend...Po ju keni kredi të gjeni një makinë tjetër,por,meqë vetë ma kujtuat,nuk do të bëhej qameti edhe sikur njëherë të vetme të udhëtonit me tren...

Shkëlqimi – Sikur të ishte një rast i vetëm,edhe mund të udhëtoja...Po sëmundjes tënde nuk i dihet sa zgjat...Po sikur të të rregulloja një vend të mirë në oficinë?

Besimi – (*shpërthen*) Pse s’a thua troç,o drejtor?Thuaj,që ti,Besim,nuk je për mua,se dua të të heq qafe e të sjell një tjetër,që të mos m’i kundërshtojë urdhrat,edhe kur ata nuk janë të drejta...Thuaje më mirë ballas,atë që ma ke thënë kaq herë në heshtje qysh atë natë...Nuk është sëmundja ime ajo,që të bën të flasësh kështu,po sëmundja yte...Mjerë ai,që ka një sëmundje të tillë...Urdhëro çelsat!(*del me nxitim*)

Tana – (*që hyn*) Ç’u bë Besimi?

Shkëlqimi – Iku...

Tana – Si iku pa pirë kafënë?

Shkëlqimi – Ja që s’deshi ta pinte...

Tana – Ti e ke përzënë...

Shkëlqimi – Aspak.Dhe të lutem,nënë,më ler rehat, se kam një qerre telashe mbi kokë...Më dalin e më teprojnë...

Tana – Tjetri nuk ta ka borxh.Mezi rrinte në këmbë..Edhe në fytyrë qe zverdhur si limoni...

Shkëlqimi – Do të bëhet mirë!(*Hyn Perlati*)Eja,Perlat,eja!

Perlati – Nuk kam ardhur të rri...Kam ardhur të të them veç dy fjalë...

Shkëlqimi – Ulu,ulu,nuk bisedohet në këmbë...Dhe mos rri i ngrysur!

Perlati – Jo,prej shendit!Nuk ka gjë më të hidhur se një gëzim i parakohshëm....Pse më hoqe nga lista,drejtor?

Shkëlqimi – (*i zgjat një cigare,po ai e refuzon*) Të them të drejtën,Perlat, kam zor të të shoh në sy...Po të flas me gjithë zemër...U përpoqa sa munda, po,me gjithë dëshirën e mirë dhe respektin,hë për hë...

Perlati – Tani nuk më hyn në sy as dëshira e mirë,as respekti...Më shumë se për ta,kam nevojë

për shtëpi...

Shkëlqimi – Nuk po ta marr për të keq,se je i nxehur,o Perlat.Edhe unë,po të isha në kushtet tuaja,kështu do të flisja,ndoshta,edhe më shumë...Po unë nuk i shpërndaj shtëpitë..Është një komision i caktuar për këtë punë...

Perlato – Kryetar i të cilit jeni ju...

Shkëlqimi – (*përpiqet ta zbusë*)Duhet të tregohemi zemërgjërë,o perlat!Me ata hyrje që kishim,u sitemuan shokët tanë...e kjo duhet të na gëzojë...E di,se ç'mund të mendosh ti tani,që problemi yt nuk u zgjidh,po kjo është diçka e përkohëshme...Tremujorin tjetër do të jesh i pari në listë...

Perlato – Përse nuk latë një tjetër për tremujorin e ardhshëm?Ndonjërin që s'kishte kushtet e mia...Nuk kam ndërmend të zë me gojë të gjithë emrat dhe ata i gëzofshin shtëpitë,por,po ta kishit parë me dorë në zemër,të paktën para Sados,marangozit,duhej të isha...(del)

Tana – Nuk ia paske zgjidhur hallin Perlato?A e di,more,si na është gjendur në kohë të vështira?Ç'pret,të të trokasë në derë tash e parë e mendjen të ta bëjë çorap?Nuk është nga ata Perlato...Halli i madh e ka shtyrë të bjerë në qafë e hallin ia dimë të gjithë...

Shkëlqimi – E di,moj,nënë,e kuptoj,po ç'të bëja?

Tana – Ta lije cilindo për herën tjetër e t'i jepje shtëpi një sahat e më parë! Ja,këtë të bëje!..Posi...Dhe jo,pse e kemi komshi e na është bërë krah,por sepse i takon!

Shkëlqimi – Bëra ç'ishte e mundur..

Tana – Hiç!Një vrimë në ujë ke bërë...E përcolle me fjalë të bukura... Posi. Edhe Besimin e përzure e kafja më mbeti nëd orë...Pse,nuk e di unë,pse ta lë tjetri kafenë në dorë?Kushedi ç'i ke thënë edhe atij!...Po pse kështu,more bir,pse?Njeriu s'ka nevojë vetëm për fjalën e mirë,por edhe për punën e mirë...E shoh,se të mërzita...

Shkëlqimi – (e përqafton) Jo,nënë,jo...Nuk mërzitem nga ti....Telashe kemi shumë e nxehemi ndonjëherë...

Tana – Sikur të ishte vetëm kështu!

Shkëlqimi – Nuk të kuptova...

Tana – Je bërë disi ndryshe,mor bir..nuk je më i pari..E ndjej,e shoh..

Shkëlqimi – Ashtu të duket...

Tana – Veç mos harro kurrë,nga ç'rrënjë ke dalur dhe degë e cilit trung je...

Shkëlqimi – E kam për nder prejardhjen time.

Tana – Kur bën biografinë dhe me fjalë...Po fjalët i merr era,punët mbesin...

Shkëlqimi – Punës i kam ndenjtur te koka si...

Tana – Disave...Me njerëzit ke harruar të sillesh...Në ç'pasqyrë i kreh flokët,mor bir?

Shkëlqimi – Pse ma bën këtë pyetje?

Tana – Sepse ,më duket,të është rritur mendja...

Shkëlqimi – S'ke faj,dëgjove atë budallaçkën atë natë dhe të ka mendur mendja aty...

Tana – Nusja kishte të drejtë...Tërë këto ditë nuk na ka ardhur...Me siguri,që nuk i ke kerkuar falje...Pse të shkosh,të bie hunda dhe,që ta dish,unë kurrë nuk kam ecur me kokën e tjetrit...E pashë edhe sonte.Kështu sillesh edhe me ata,që ke mbi kokë?

Shkëlqimi – Pyeti,se ç’thonë!...

Tana – Fjalë të mira thonë..Kam dëgjuar nga Fuati...Po,se si është zënë brumi dhe ç’yndyrë kanë petët,këtë,më më mirë se kushdo e di amvisa...Të tjerët veç e hanë e mud të thonë,ç’byrek i mirë qenka!

Shkëlqimi – Edhe amvisa nuk flet keq për mua jo,se ditë e natë po shtrydh trutë për këtë uzinë,për ata njerëz,që në fund të pesëmbëdhjetëditëshit të mbushin xhepat...

Tana – Janë të djersës së tyre..

Shkelqimi – Edhe times!

Tana – Edhe tëndes.Por paratë nuk janë gjithçka,duhet shpirti...Se çdo ditë mund të ma sjellësh kafënë te shtrati,por,po nuk ma dhe me shpirt,ajo s’të shijon dhe mezi e shtyn teposhtë...Dhe një gjë desha të them...Mos harro,se sado i lartë të jetë lisi,rrënjët i ka në tokë...Po nuk i pati të forta,rrëzohet...

Shkëlqimi – Rri pa merak,nënoke,se jam nga ata lisa që nuk rrëzohem lehtë...(ndrron bisedë)E di,nënë,edhe Ministria ka mendim të mirë për linjën e re...Kështu me tha shoku Klement...Nuk e ke idenë,me sa pasion që fliste..(Pauzë)I kam menduar të gjitha,deri në detaje..Një të ardhur aprovimi,do t’ia nis punës menjëherë dhe pastaj...(Nena del ngadalë.Ai nuk e dallon i zhytur në entuziazmin e tij dhe bën me shenjë për lart)Ku ta dish, ndoshta dy tri shkallë!...

Bie zilja që i ndërpret meditimin.Hyn Besniku.

Besniku – Sa mirë të gjeta...

Shkëlqimi – Ç’kishe?Ka dalë ndonjë yckël në uzinë?

Besniku – Jo...Më jep pak të shoh edhe njëherë rezultatin e analizave të lënës së parë...

Shkëlqimi – Analizat?Pse?

Besniku - Ta them pastaj...

Shkëlqimi – Ka gjë që nuk shkon?

Besniku – Dyshoj...

Shkëlqimi – Po ti,çne në këtë mes?Ne i kemi diskutuar njëherë në këshillin shkencor dhe e kemi vendosur...

Besniku – E di,por desha të bëj një verifikim...Hë,pra,silli,ç’pret?(Shkëlqimi i sjell.Besniku nxjerr një letër të bardhë e, e vendos në tavolinë dhe e krahason me atë të Shkëlqimit) Tamam!I njejtë rezultat!

Shkëlqimi – More,po ç’është kjo fletushkë,se më tërbove!

Besniku – Përsëritja e analizave...

Shkëlqimi – I paske bërë ti?Me ç’të drejtë?Studimi e ka një autor!...

Besniku – E di,nuk kam ndërmend të kërkoj pjesë...

Shkëlqimi – Atëherë,pse je munduar?

Besniku – Ia vlente..T’i japësh një ndihmë shokut në kohën e duhur,nuk duhet quajtur mund...

Shkëlqimi – Më duket,se këtë nuk ta ka kërkuar njeri dhe,në raste të tilla, nuk ke pse gërmon...

Besniku – Diçka më e fortë se marrëdhënjet tona më ka detyruar...Interesi i përgjithshëm!

Shkëlqimi – *(ironik)*Të lumtë!Konkluzioni?

Besniku – Linja e re s’duhet hapur!

Shkëlqimi – *(i befasuar)*Çfarë?

Besniku – Të paktën,jo tani për tani...Lënda ekzistuese nuk i plotëson kushtet teknologjike,që kërkon malli i ri...

Shkëlqimi – Nuk të takon ty të vendosësh për këtë...Linja do të hapet!

Besniku – *(me të butë)*Jo,Çimi,le ta lëmë inatin e të flasim me logjikë të ftohtë...Të lutem,mos më ndërprit deri në fund.

Shkëlqimi – Nuk të lejoj,sepse i kuptoj të gjitha motivet,përse po e ben këtë...

Besniku – Asgjë nuk kupton,kur sytë i ke të veshur nga euforia e një suksesi të madh e të mundshëm...

Shkëlqimi – Por jo nga cmira!

Nga njera prej dhomave lart del Donika.Ndalon tek shkallët.

Besniku – Të lutem,Shkëlqim,mati fjalët!Nuk kam ardhur të zihem e as të më fyesh kaq rëndë!Për këtë që the,sikur të bëhej fjalë për diçka që na përkiste vetëm ne të dyve,do të isha ngritur në çast,por,meqenëse nuk është kështu,duhet të më dëgjosh deri në fund.Pastaj më ngjish cilin epitet të duash...Pak më lart,të thashë ,se erdha tek ti me mendimin,se vija tek shoku për t’i dhënë një ndihmë...Unë për vehte do t’ia dija shumë për nder një tjetri,po të më parandalonte një gabim,që më vonë do të kthehej në faj të rëndë...

Shkëlqimi – Sikur po na shtije shumë në borxh,mor inxhinier e nuk e di, a do të jem në gjendje ndonjëherë të ta shpërblej...

Besniku – *(prerë)*Do të më dëgjosh,apo si e ke hallin?

Shkëlqimi – *(tallës)*Mirë,inxhinier,mirë, përderisa jeni munduar,urdhëroni...

Besniku – *(përmbahet)*Kur patë diskutuar bashkë projektin e linjës së re,neqofte se të kujtohet,të pata pyetur në i ke ballafaquar rezultatet e punës me kliteraturën botrore,se,siç e di më mirë se unë,këtë lloj malli,që do të prodhonte linja e re,e prodhojnë disa shtete të tjerë...Në fakt,del,që s’e ke bërë këtë ballafaqim,ose e ke bërë përciptas...

Shkëlqimi – *(fillon të parandjejë diçka)*Nga e nxjerr këtë konkluzion?

Besniku – *(nxjerr nje libër)*Literatura i përcakton qartë parametrat e domosdoshëm teknologjike,që duhet të ketë lënda e parë dhe,që në rastin konkret,siç del nga analizat që ke bërë ti dhe nga ata që përsërita unë,del,se kjo lëndë e parë që kemi tani për tani,nuk i plotëson këto kushte...Unë mendoj,se do të ishte aventurë që të mos përfillehin,sepse linja e re mund të ngrihet,mallrat mund të prodhohen,po ka rrezik që ata të mbeten stock,ngaqë tregu i jashtëm mund të na i kthejë...

Shkëlqimi – *(ia ngul sytë)*Më thuaj sinqerisht,përse ke gërmuar kaq gjatë?

Besniku – Ç’i jep rënëdi kësaj...

Shkëlqimi – Ma thuaj...

Besniku – Nuk më kishte pëlqyer puna jote e mbyllur. Më pas shihja një lloj ngutjeje e, njeriu kur ngutet, do të harrojë diçka... Dhe shfletova...

Shkëlqimi – Vetëm për këtë?

Besniku – Vetëm për këtë!

Shkëlqimi – Tani që dështova, ç'ndjen?

Besniku – Ç'është kjo pyetje?

Shkëlqimi – Fol!

Besniku – Nuk më vjem mirë, po të ketë emrin dështim, po ti prap po ngutesh.. Nëqofte se lënda ekzistuese nuk i plotëson kushtet teknologjike, mund të gjëndet një tjetër më e mirë...

Shkëlqimi – Ku? Kur?

Besniku – Diku dhe dikur! Por ama nuk do të çoheshin dëm miliona dhe ti nuk do të viheshe në pozitë të vështirë...

Zëri i Fuatit në mikrofon – “ Le ta përfundojë punën që ka në dorë, pa shpejt do ta shohë veten lart, ku ta dish, mbase dy tri shkallë, shkallë, shkallë”

Shkëlqimi – (histerik) Ky është dështim, dështim, dëgjovje? Tani qetësohu! Ma zure vendin!...

Besniku – Shkëlqim, eja në vehte!

Shkëlqimi – Po, po, fryhu prej shendit! Fitove! Unë dështova! (*Donika zbret me të shpejtë nga shkallët*)

Donika – Shkëlqim!

Shkëlqimi – Këtu paske qenë, motër? Me siguri që prisje finalen e shfaqjes! Të pëlqeu?

Donika – (*kërkon ta zbusë*) Të lutem, Çimi!

Shkëlqimi – Të vjen keq për vëllain, apo të vjen mirë për shokun evëllait... (*Besniku matet të dalë*) Mos ik, i pabesë! Të gjitha vrimat e skutat shtëpisë i ke ditur...

Besniku – (*i përmbajtur*) Çdo njeri ka të meta... Një herë e një kohë i kam vënë re edhe tek ti... Po nuk më kishte shkuar mendja, se një ditë ato do të zmadhoheshin aq shumë, sa të të kthejnë në një përbindësh! (*del*)

Shkëlqimi – Hë, motër, e dëgjovje si folën për tët vëlla?

Donika – Po im vëlla e di, se nxjerr nga goja? Nikut t'i thuash i pabesë? Sa turp! (*mezi i mban lotët*)

Shkëlqimi – Mbroje, mbroje, pse të mos e mbrosh!... Këtu edhe rrugëve, kur të bredhësh me të!... (*nga dhoma del Tana*)

Donika – Do ta mbroj, se ka të drejtë! Sa për atë mbrëmje, kujdes se po më rëndon!...

Shkëlqimi – Kërkon ta mohosh? Po njerëzit kanë sy e shohin...

Donika – E di, informatat i ke të sigurta... Ai vjehri yt...

Shkëlqimi – (*e ndërpret*) Atë mos e zër me gojë!

Donika – Edhe ti mendo mirë, se ç'flet!

Shkëlqimi – E pra, atë (*për Besnikun*) të mos ta shoh më kurrë këtu!...

Donika – Se me kë rri e me kë shkoj, ty nuk të jap llogari... Jam në gjendje të përcaktoj, ç'është mirë e ç'është keq!

Shkëlqimi – (*Tanës*)Dëgjoje,dëgjoje,tët bijë...
Tana – Shkëlqim,mor bir,nuk bën kështu!...

Dritat

Tabloja e gjashtë

Paraskenë

Lira nxiton.Fill mbas saj Fuati që pothuajse vrapon.

Fuati – Lira,prit!Ku shkon?

Lira – Pse nuk e di,baba?Në uzinë...

Fuati – Nuk duhet të shkosh...

Lira – Duhet...

Fuati – Pse t’i lutesh?Kaq ditë që nuk i flisni njeri tjetrit...Mos harro,se ke personalitet...Tek e fundit,më mirë që ndoshi kështu...

Lira – Si the,baba?

Fuati – Aq mend ke ti!Nuk e merr vesh,se atje janë mbledhur për t’i bërë gjyqin?

Lira – Dhe unë çfarë të bëj?

Fuati – Atë që duhet bërë në raste të tilla...Fejesa është thjeshtë një provë...Jemi për njerë tjetrin-mirë,s’jemi...

Lira – Ndahemi...

Fuati – Pikërisht...Njerëzit ndahen edhe të martuar...Edhe me fëmijë...Ju s’jeni as të martuar,as fëmijë nuk keni...

Lira – Kam dashurinë...

Fuati – Që ta fyu,ta mohoi...

Lira – Deri dje përpiqeshe të më mbusgje mendjen,të më qetësoje,ta justifikojë,t’i jepje të drejtë...

Fuati – Sot është ndryshe...

Lira – Baba,tl lutem!

Fuati – Mirë,atëherë,presim rezultatin...

Lira – E nëqoftëse nuk do të jetë pozitiv?

Fuati – Ti nuk bëhesh gruaja e tij!...(Lira e sheh dhe ikën duke qarë.Fuati shkon ngadalë drejt saj)

Një zë në mikrofon – “Askush nga ne nuk ka dashur, që puna të vijë deri këtu dhe për këtë jemi përpjekur,kryesisht me këshilla shoqërore,duke menduar, se Shkëlqimi do të reflektonte drejt.Por këtu u sollën shumë fakte...Pastaj ka edhe diçka tjetër,që e rëndon më tepër në faj...”

Zëri sfumohet.Kur ndezen dritat,jemi në shtëpinë e nënë Tanës.Janë mbledhur të gjithë.Rrinë në heshtje të zhytur në mendimet e tyre.Të gjithë janë të shqetësuar.Befas Tana ngrihet.

Tana – Sa shkoi ora?

Gramozi – Tetë!

Tana – Plot tri orë...

Gramozi – Po...(Tana shkon drejt derës) Ku shkon?

Tana – Atje.Nuk mund të pres më...

Gramozi – E ç’do të bësh?

Tana – Nuk e di,po këtu s’më zë vendi...Kusuret i paska të rënda...

Gramozi – Po...

Tana – Kështu të tha Viktori?

Gramozi – E takova rastësisht.E ka shkelur keq,më tha...

Donika – Ti shko më mirë e shtrihu,nënë,të qetësohesh...

Tana – Të qetësohem?Po si mund të qetësohet një zemër e plasur? Nuk ka plagë më të rëndë,se ajo që të hap gjaku yt...Ajo të therka fort,sa të merrka frymën...

Donika – Sidoqoftë shtrihu...Mbase janë vetëm gabime pune...

Tana – Jo,moj e mira e nënës...Edhe kur pyeta Gramozin, desha të gënjej vehten,po unë e kuptoj,e ndjej,se ai i ka zemëruar njerëzit aq, sa kanë humbur durimin...(Ligështohet.Të tre vrapojnë.)S’kam gjë... Do të më kalojë...

Gramozi – (Donikës)Piqi një kafe!

Donika – S’i bën mirë për tensionin...

Tana – Sonte kam nevojë për një kafe të fortë!...

Gramozi – Megjithatë s’duhet ta lëshosh veten.Kështu na ke mësuar.....

Tana – Eh,sikur mos të harroheshin fjalët e nënave!...

Gramozi – Të nënave të mira...

Tana – Ke të drejtë,se prindi i mirë rrit fëmijë të mirë....

Donika – Gramozi nuk e pati fjalën aty...Ti je...

Tana – Nuk vlen!Atje në uzinë janë mbledhur për të gjykuar njerin nga fëmijët e mi...E si mund ta quaj veten një nënë të nderuar?

Gramozi – Ti ke bërë shumë për ne!Për këtë ti duhet të jesh e qetë...Dhe ne e kemi për nder që jemi fëmijët e tu...

Tana – Po jam edhe nëna e tij,more...Si thua, ta mohoj?

Gramozi – Jo...Po nuk është gjithçka në dorë të prindit...

Tana – Pse,ç’deshi ai,edhe shokët të mirë i kishte...

Gramozi – Po ndodh,që të hyn vetja në qejf...Ke marrë ca nota të mira në universitet,edhe në punë ke patur suksese,të bëjnë edhe drejtor dhe fillon të mendosh,se kape retë me dorë...Nuk ka si ti,ti je më i miri,më i zoti,të tjerët nuk dinë gjë,prandaj fjala jote duhet të jetë ligj,posi,dhe nis e fluturon...Pa mund të vijë një çast që oreksi të rritet,të kërcen dëshira e ngritjes,ta bën me sy ndonjë post më lart,jo për gjë,por se e meriton,se je më i mniri,pra, dhe nis e thur ëndrra,ndërton plane,mbledh rreth vetes ata, që të fërkojnë krahët,të gudulisin ëndrrën,kurse çaprazëve,që ta përplasnin në sy,u fut brrylin....E ç’ta zgjas,shqip,të merr koka erë...

Donika – Natyrisht që kjo ndodh me disa,jo me të gjithë...

Gramozi – E thashë,pra,vetëm atyre që u merr koka erë!...

Hyn Lira.

Lira – Mirëmbërëma!Më falni!

Tana – Sa mirë që erdhe,moj e mira e nënës!

Lira – Më duket se ju ndërpreva bisedën...Po flisnit për Shkëlqimin,apo jo?

Tana – Ja...ashtu...

Lira – E di,e di...Ashtu si ju edhe unë jam shqetësuar shumë...Doja ta prisja në uzinë, po nuk munda dhe erdha këtu...

Tana – Shumë mirë bëre!Mos rri në këmbë..eja këtu pranë meje...

Lira – Të faleminderit,nënë(*i afrohet*)Po ju vazhdoni...Nëqoftese ndruheni nga unë,po dal...Nuk dua t’u pengoj...

Gramozi – Nuk na pengon...Shkëlqimi nuk është vetëm i yni...Ne po përpiqeshim të nxirrim shkaqet,pse ndodhi kështu,sepse,sa më të saktë të jemi,aq më të lehtë do ta kemi për ta shëruar...

Lira – Edhe unë kam fajin tim...Edhe babai im ka fajin e tij...

Gramozi – Fajin e ka ai,se asgjë nuk mund të më prishë,po të mos dua... Një bimë e keqe nuk mund të lindë në një tokë të mirë e të dizifektuar...

Visari –Po të më pyesni mua,ju mbaj me netë të tëra...Po edhe ti,Donika,nuk je dorëjashtë,edhe ti,mama...Këtu e kam fjalën për zënkat pa shkak,jo,pse nuk vuija heret në shtëpi,jo pse shoqerohesha me këtë apo atë...Ngandonjëherë ti,mama,i jepse të drejtë,pa pasur të drejtë...

Tana – Doja të shuaja shamatën...Nuk e kam dashur kurrë...Pastaj ti ishe më i ri...Ai ..vëllai yt...

Visari – Këtu është e keqja, se,edhe kur fliste në emër të vëllait,hallin e kishte për vehte...Eh,kjo perspektiva,që i hëngri kjokën!Ua kisha thënë me kohë,po s’më besonit...Fol,Donika,si u soll me Besnikun,vetë pse ia uli hundën!

Donika – Visar!

Visari – Sonte nuk duhet fshehur asgjë...

Donika – Visar,të lutem!

Tana – Sado që të përpiqesh,moj bijë,gjërat nuk i fsheh dot...(Gramozit) Gramoz,e shoh, se diçka

të ka mbetur pa thënë!

Gramozi – Jo,jo,asgjë!

Tana – Ty të njoh mirë, se bashkë i kemi ndarë hallet...Visari kishte të drejtë,kur tha,se sonte nuk duhet fshehur asgjë...

Gramozi – Është e rëndë...

Tana – Thuaje!

Hyn Shkëlqimi.Gramozi me shpinë nga dera nuk e vë re.

Gramozi – Ai ka marrë para!(*reagim*)

Tana – Mos!Harami!

Shkëlqimi – Nuk është e vërtetë,nënë!Nuk është e vërtetë,Gramoz!E thashë edhe atje...Nuk është e vërtetë,më besoni!

Gramozi – Pse nuk mori shtëpi Perlati?

Shkëlqimi – Ia punova keq,po para nuk kam marrë...(shikon *Lirën me keqardhje*) Këtë e kam peshqesh prej dikujt tjetër...Ai ka marrë në emrin tim!...Për të tjerat gjykomëni...Këtu më keni dhe bjermëni,sa t'u hanë duart...Nuk do t'u kundërshtoj...

Visari – E ç'vlerë ka tashti?Çshtë vonë të thuash kështu...Ti vërtetë re në gjol,po mos harro,se na ke stërpikur edhe neve!

Gramozi – Visar!(*Shkëlqimit*)Eja,ulu!Sonte nuk kemi ç'ta zgjasim më...Veç një fjalë me dëgjo:ato që të kanë thënë atje,përpiqu t'Çi ndjesh thellë e t'i bësh tuajat,sonte nuk i bën dot,por me kohë...Dhe veten mos e lësho!Vërtetë të rrëshqiti klmba e re nga mali,po kockat ngjiten prap dhe kokën në vend e ke...

Shkëlqimi – E ç'më duhet?

Gramozi – Ta mbash mbi shpatulla siç duhet mbajtur...E di,që nuk është e lehtë,por as e pamundur...

Hyjnë Besniku dhe Bujari.

Tana – Ejani,të mirët e nënës!Ja ku e keni...Më shumë se kurrë ai do të ketë nevojë për ju,për ne...

Dritat

Nëntor 1986 – Nëntor 1988,Shkodër.

